



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 68

Tiranë – E premte, 7 maj 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 30/2021, datë 8.3.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar..... 6709
Ligj nr. 32/2021, datë 16.3.2021	Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit..... 6709
Vendim i Kuvendit nr. 32/2021, datë 4.5.2021	Për rrëzimin e dekretit nr. 12 055, datë 26.3.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 30/2021 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018, ‘Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme’, të ndryshuar”..... 6733
Vendim i Kuvendit nr. 33/2021, datë 4.5.2021	Për rrëzimin e dekretit nr. 12 078, datë 6.4.2021, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 32/2021, ‘Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit’”..... 6733
Vendim i Kuvendit nr. 45/2021, datë 7.5.2021	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”..... 6733
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 5.5.2021	Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 6734
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 5.5.2021	Për lirim nga detyra..... 6735
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 5.5.2021	Për emërim në detyrë..... 6735
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 249, datë 5.5.2021	Për emërim në detyrë..... 6735

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 253, datë 5.5.2021	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi) dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), për mbështetjen e projektit “Implementimi i taksës së pasurisë të bazuar në vlerën e tregut, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018”, miratuar me vendimin nr. 408, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave.....	6735
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 254, datë 5.5.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 872, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2021, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)”	6737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 5.5.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 175, datë 17.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal ‘Memorial’ në Fier, si projekt pilot”	6737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 259, datë 5.5.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 789, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të certifikimit për profesionistët e shëndetësisë”, të ndryshuar.....	6738
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 5303, datë 4.5.2021	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe.....	6738
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).....	6738
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 98, datë 16.4.2021	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.....	6742
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 16.4.2021	Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Vardari”, me kapacitet të instaluar 1972 <i>kw</i>	6743
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 16.4.2021	Mbi modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, të miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të shoqëria “Kurum international” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Ulëz”, me kapacitet të instaluar 24 <i>mw</i>	6746
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 16.4.2021	Mbi shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 202, datë 2.12.2020, për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepçicave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”	6748
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 102, datë 16.4.2021	Mbi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e propozimit të shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., për disa ndryshime në rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike.....	6749

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 103, datë 16.4.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2021.....	6750
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3848, datë 4.5.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit “Sistemimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës në ‘Bllokun Qemal Stafa’ kufizuar nga rrugët ‘Kongresi i Manastirit’ dhe ‘Bajram Curri’, Tiranë”.....	6751



LIGJ
Nr. 30/2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN Nr. 12/2018, “PËR
VLERËSIMIN KALIMTAR DHE
PERIODIK TË PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHETIT, GARDËS SË
REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR
ÇËSHJTJET E BRENDSHME DHE
ANKESAT NË MINISTRINË E
BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 2, të Kushtetutës, me propozimin e deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

1. Shtohet neni 68 me këtë përmbajtje:

“Neni 68
Dispozitë kalimtare

Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës pezullohet deri në përfundimin e procesit të vlerësimit kalimtar të trupës së vlerësimit të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave.”

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 8.3.2021.

LIGJ
Nr. 32/2021

**PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NË
SEKTORIN E TRANSPORTIT¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Neni 2
Fusha e veprimt

1. Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin:

a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;

b) sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;

c) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit lundrues për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;

ç) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të avionit për dëmet e shkaktuara

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

Direktivën 2009/103/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 shtator 2009, “Për sigurimin e përgjegjësisë civile, në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe zbatimin e detyrimit për të siguruar një përgjegjësi të tillë”. Numri CELEX 32009L0103, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 263, datë 7.10.2009, faqe 11–31.



palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për kategori të veçanta mjeteve motorike të Forcave të Armatosura.

3. Kategoritë e veçanta të mjeteve të Forcave të Armatosura, procedurat dhe pagesa e dëmshpërblimit për dëmet e shkaktuara nga përdorimi i këtyre mjeteve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për mbrojtjen dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksident” është ngjarja ku rezultojnë dëm nga përdorimi i mjetit të transportit.

2. “Autoritet” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. “Avion” është çdo mjet transporti sipas përcaktimeve të dhëna në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë.

4. “Byro” është Byroja Shqiptare e Sigurimit, e krijuar sipas nenit 35 të këtij ligji, anëtarë të së cilës janë shoqëritë e sigurimit, që janë të licencuara në Republikën e Shqipërisë për të ushtruar veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji.

5. “Dëmi ndaj pronës” është dëmi i pësuar si rezultat i dëmtimit ose i shkatërrimit të pronës.

6. “Dëmi ndaj personit” është dëmi që vjen si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore dhe përkeqësimeve të shëndetit, që pësojnë pala e dëmtuar ose të afërmit e tij. Këtu përfshihet dëmi pasuror dhe dëmi jopasuror.

7. “Dëmi pasuror” është humbja e pësuar nga pakësimi i pasurisë, si dhe fitimi i munguar.

8. “Dëmi jopasuror” është dëmi biologjik, ekzistencial dhe moral i pësuar nga cenimi i të drejtave dhe i interesave jopasurore, që lidhet me dhimbjet fizike, paaftësinë për punë, frikën, shëmtimin, dhimbjet dhe vuajtjet shpirtërore të personit të dëmtuar dhe familjarëve të tij në rastin e vdekjes së personit ose përkeqësimit të shëndetit të tij.

9. “Drejtuues i paautorizuar” është personi, i cili në rastin e aksidentit drejton mjetin pa lejen e

pronarit të mjetit, nuk është punësuar prej tij për të drejtuar mjetin, nuk është anëtar i familjes së tij dhe nuk e ka marrë mjetin në dorëzim nga pronari.

10. “E drejtë e posaçme e tërheqjes” (*Special Drawing Rights-SDR*) është njësi monetare e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

11. “Fluturim i avionit” në lidhje me:

a) pasagjerët dhe bagazhet e tyre personale, të vendosura në bordin e avionit, është periudha gjatë së cilës pasagjerët transportohen me avion;

b) mallrat dhe bagazhin e regjistruar është periudha e transportimit të mallrave dhe bagazheve nga koha e regjistrimit të bagazhit ose dorëzimit të mallrave të transportuesi përkatës ajror deri në kohën e dorëzimit të tyre të marrësi ose pritësi i autorizuar;

c) palët e treta është periudha e përdorimit të avionit nga koha e ndezjes së motorëve për ngritjen nga sipërfaqja e tokës deri në kohën kur avioni ulet në sipërfaqen e tokës dhe motorët e tij janë tërësisht të fikur, si dhe lëvizja e një avionit me përdorimin e forcave për rimorkimin, shtyrjen ose lëvizjen e tij.

12. “Kartoni jeshil” është certifikata ndërkombëtare e sigurimit, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Kretës.

13. “Kufiri minimal i përgjegjësisë” është shuma maksimale e dëmshpërblimit për çdo figurë dëmi të njohur nga ky ligj, që siguruesi merr përsipër t’u dëmshpërblejë palëve të treta të dëmtuara në një ngjarje sigurimi.

14. “Marrëveshja e Kretës” është marrëveshja që rregullon marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet zyrave kombëtare të vendeve anëtare të sistemit të kartonit jeshil.

15. “Mjet transporti” është mjeti motorik, mjeti lundrues dhe avioni.

16. “Mjet motorik” është mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave, subjekt i detyrimit për regjistrim. Mjet motorik është edhe rimorkioja dhe gjysmërimorkioja të bashkuara ose jo me mjetin motorik tërheqës.

17. “Mjet motorik i pasiguruar” është mjeti i përkufizuar në pikën 16 të këtij neni, por për të cilin nuk është lidhur kontrata për sigurimin e përgjegjësisë, që rezultojnë nga përdorimi i mjetit, ose periudha e sigurimit ka përfunduar dhe kontrata e sigurimit nuk është rinovuar.



18. “Mjet motorik i paidentifikuar” është mjeti i përkufizuar në pikën 16 të këtij neni, për të cilin nuk ka qenë i mundur të bëhet as identifikimi i mjetit dhe as i siguruesit përgjegjës.

19. “Mjet lundrues” është çdo mjet transporti i destinuar për lundrim, i regjistruar sipas përcaktimeve të Kodit Detar.

20. “Përdorues i një mjeti transporti” është një person fizik ose juridik që përdor mjetin e transportit me miratimin e pronarit.

21. “Pronar i mjetit” është çdo përdorues ose person tjetër i regjistruar si pronar i mjeteve të transportit në përputhje me ligjin.

22. “Policë sigurimi” është kontrata e sigurimit sipas këtij ligji.

23. “Palë e dëmtuar” është çdo person që ka pësuar dëme si pasojë e aksidentit, të cilit i lind e drejta të kërkojë dëmshpërblim sipas këtij ligji për humbjet ose dëmtimet e pësuar, të shkaktuara nga mjeti i transportit.

24. “Përdorues avioni” është personi, i cili përcakton mënyrën e përdorimit ose të veprimit të avionit, ose personi në emër të të cilit është regjistruar avioni në regjistrin shqiptar të avionëve civilë ose në ndonjë regjistrë tjetër të barasvlershëm të avionëve.

25. “Sigurues i drejtpërdrejtë” është shoqëria e sigurimit me të cilën pronari i mjetit motorik të dëmtuar ka lidhur kontratë për sigurimin e detyrueshëm sipas këtij ligji.

26. “Sigurues përgjegjës” është shoqëria e sigurimit me të cilën pronari i mjetit të transportit që ka shkaktuar dëmin ka lidhur kontratën për sigurimin e detyrueshëm.

27. “Sistemi *bonus-malus*” është faktor për përcaktimin e nivelit të primit të sigurimit të detyrueshëm motorik, ku primi i aplikuar është i varur nga historiku i numrit të dëmeve.

28. “Territori ku përdoret automjeti” është:

a) territori i vendit, targën e regjistrimit të të cilit mban mjet motorik, pavarësisht nëse targa është e përhershme apo e përkohshme;

b) shteti që lëshon targën e sigurimit ose çdo shenjë tjetër dalluese, analoge me targën e regjistrimit, të konceptuar për mjetet motorike, në rastet kur për tipa të veçantë mjeteve motorike targa e regjistrimit nuk është e nevojshme;

c) shteti në të cilin përdoruesi i mjetit motorik ka qëndrim të përhershëm, në rastet kur tipi i caktuar i mjetit nuk ka nevojë për targë regjistrimi

apo për targë sigurimi ose ndonjë shenjë tjetër dalluese, analoge me targën e regjistrimit;

ç) shteti në të cilin ka ndodhur aksidenti rrugor, në rastet kur mjeti motorik i përfshirë në aksident nuk ka targë regjistrimi ose targa e regjistrimit nuk i përgjigjet ose nuk i përket më atij mjeti.

29. “Transportues ajror” është çdo operator që ka një dëshmi aftësie ose një licencë tjetër ekuivalente për të vepruar në transportin ajror.

30. “Zona e shteteve anëtare të sistemit të kartonit jeshil” është territori i shteteve anëtare të sistemit të kartonit jeshil, sipas rregullave ose marrëveshjeve të Këshillit të Byrove.

31. “Nënshkrim elektronik” ka të njëjtin kuptim me legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik.

Neni 4

Detyrimi për t’u siguruar

1. Pronari i çdo mjeti transporti përpara përdorimit të mjetit është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.

2. Kur mjeti i transportit është subjekt i detyrimit për t’u regjistruar ose certifikuar dhe, sipas ligjit, duhet të ketë një certifikatë regjistrimi/kontrolli teknik, autoritetet përgjegjëse lëshojnë certifikatën e kontrollit teknik ose ndonjë dokument tjetër të barasvlershëm me të, vetëm pasi pronari i mjetit të transportit i provon këtij autoriteti me dokumente se e ka lidhur kontratën e sigurimit sipas këtij ligji. E njëjta kërkesë zbatohet edhe për subjektet që licencohen sipas ligjit “Për transportin rrugor”. Autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të sigurojnë përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë.

3. Kur personi i autorizuar për kontrollin e trafikut vëren shkelje të pikës 1 të këtij neni, vendos masën e dënimit administrativ me gjobë sipas parashikimeve të Kodit Rrugor.

4. Sigurimi i përgjegjësishë së pronarit të mjetit të transportit për dëme shkaktuar palëve të treta mbulon edhe dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit prej personave të tjerë, kur këta e përdorin mjetin me miratimin e pronarit.



Neni 5

Detyrimet e pronarit ose përdoruesit të mjetit të transportit

1. Pronari/përdoruesi i mjetit të transportit gjatë përdorimit të tij është i detyruar të mbajë me vete policën e sigurimit ose ndonjë provë tjetër të lidhjes së kontratës së sigurimit të detyrueshëm, si dhe Raportin Evropian të Aksidenteve.

2. Pronari/përdoruesi i mjetit lundrues është i detyruar të mbajë me vete policën e sigurimit ose ndonjë provë tjetër të lidhjes së kontratës së sigurimit të detyrueshëm.

3. Në rast aksidenti, drejtuesi i mjetit është i detyruar të japë të dhënat personale dhe të dhënat që lidhen me sigurimin e detyrueshëm, sipas këtij ligji, të gjithë personat e përfshirë në aksident, të cilëve mund t'u lindë e drejta të kërkojnë dëmshpërblim.

Neni 6

Detyrimi për të dhëna

Organet e autorizuar për kontrollin e trafikut, organet gjyqësore dhe organet e tjera, që zbatojnë procedurat në rast aksidenti ose kanë në dispozicion të tyre të dhëna për aksidentin, duhet t'u vënë në dispozicion shoqërive të sigurimit dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit për trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim.

Neni 7

Tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm

1. Shoqëria e sigurimit i përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm për mjetet motorike, duke marrë parasysh faktorët e riskut.

2. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendrike përpara aplikimit të tarifave të reja të primit dhe depoziton në Autoritet bazat teknike, faktorët e riskut dhe vlerësimet aktuariale të përdorura për llogaritjen e këtyre primeve, të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar të shoqërisë.

3. Autoriteti në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit urdhëron rishikimin e tarifave të reja të primeve nëse konstaton se baza e të dhënave për hartimin e tabelave të primit nuk është e saktë ose shoqëria e sigurimit nuk ka vepruar në përputhje me parimet

aktuariale dhe metodologjinë e përdorur për përfshirjen e faktorëve të riskut të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti.

4. Tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm nuk mund të ndryshohen më shumë se dy herë brenda një viti kalendarik.

5. Shoqëritë e sigurimit duhet të krijojnë provigjone teknike jo më pak se niveli i provigjoneve teknike i përcaktuar me rregullore nga Autoriteti.

6. Komisionet e ndërmjetësimit nuk mund të jenë më të larta se niveli i përcaktuar me rregullore nga Autoriteti.

7. Shoqëria e sigurimit nuk mund të aplikojë tarifa të primit të shkruar bruto të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

8. Shoqëria e sigurimit mund të përfshijë sistemin *bonus-malus* në përcaktimin e tarifave të primeve të sigurimit të përgjegjësive të siguruarit për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti motorik, me përjashtim të policës kufitare dhe të kartonit jeshil.

Neni 8

Sistemi *bonus-malus*

1. Sistemi *bonus-malus* është sistemi për përcaktimin e nivelit të primit të sigurimit të detyrueshëm motorik, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit.

2. Sistemi *bonus-malus* është një nga faktorët e riskut, të cilin shoqëritë e sigurimit kanë të drejtë ta zbatojnë në tarifimin e sigurimit të përgjegjësive të të siguruarit të mjetit motorik, për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

3. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të vërë në dispozicion të të siguruarve certifikatën e historikut të dëmeve sipas formatit, metodës, afateve kohore dhe përmbajtjes së përcaktuar me rregulla të miratuara nga Autoriteti.

Neni 9

E drejta e palës së dëmtuar të paraqesë kërkesë për dëmshpërblim

1. Pala e dëmtuar ka të drejtë që të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te siguroesi përgjegjës i pronarit të mjetit shkaktar aksidenti. Kërkesa për



dëmshpërblim mund të paraqitet me shkrim ose në rrugë elektronike.

2. Kërkesa për dëmshpërblim përfshin dëmshpërblimin e dëmeve ndaj pronës dhe/ose ndaj personit sipas kontratës së sigurimit.

3. Siguruesit mund të lidhin marrëveshje ndërmjet tyre, sipas së cilës kërkesa për dëmshpërblim, që lidhet me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik ndaj një mjeti tjetër motorik, mund të trajtohet nga siguruesi i drejtpërdrejtë i pronarit të mjetit motorik të dëmtuar.

4. Siguruesi i drejtpërdrejtë ka të drejtën e rimbursimit të dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës sipas pikës 3 të këtij neni, sipas kushteve, limiteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet tyre.

5. Në rast aksidenti ndërmjet dy mjeteve motorike të identifikuara dhe të siguruara me kontratë siguri të detyrueshëm për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, pala e dëmtuar mund ta drejtojë kërkesën për dëmshpërblim te siguruesi i drejtpërdrejtë në rast se është lidhur marrëveshja sipas pikës 3 të këtij neni.

Neni 10

Procedura dhe afatet për dëmshpërblimin

1. Siguruesi përgjegjës është i detyruar të trajtojë çdo kërkesë për dëmshpërblim brenda afateve të mëposhtme:

a) për dëme ndaj personit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim;

b) për dëme ndaj pronës brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim.

2. Për qëllim të pikës 1 të këtij neni, data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim quhet data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues.

3. Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, në rast pranimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj.

4. Shoqëria e sigurimit kryen pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike pas përfundimit të afatit të trajtimit të dëmit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimi të

dëmshpërblimit. Në rast të mosrespektimit të afatit të përcaktuar në këtë nen, palës së dëmtuar i lind e drejta e përfitimit të interesit të pagueshëm për çdo ditë kalendarike vonesë në shlyerjen e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit.

5. Në rastet kur kërkesa e paraqitur nuk është e plotë, shoqëria e sigurimit i drejtohet kërkuarit me shkrim brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike pas pranimi të kërkesës dhe kërkon plotësimin e dokumentacionit.

6. Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, në rast refuzimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore, që çojnë në këtë refuzim.

7. Pala e dëmtuar, me marrjen e njoftimit sipas pikave 3 dhe 6 të këtij neni, ka të drejtën e ankimit pranë shoqërisë së sigurimit. Shoqëria e sigurimit është e detyruar t'i përgjigjet ankimit të palës së dëmtuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit.

8. Shoqëria e sigurimit duhet të kryejë pagesën e dëmshpërblimit në llogarinë bankare personale të të dëmtuarit ose përfituesit. Pala e dëmtuar ose përfituesi, në rast se merr shërbime nga mbrojtësi ligjor, mund t'i paguajë deri në 5% të vlerës së dëmshpërblimit të përfituar, por jo më pak se tarifat e përcaktuara në aktet përkatëse.

9. Ekzekutimi i vlerës së dëmshpërblimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm dhe deklarimi formal i pranimi të vlerës nga pala e dëmtuar ose përfituese, shuajnë përfundimisht detyrimin e shoqërisë së sigurimit. Pala përfituese e dëmshpërblimit nuk ka të drejtë të kërkojë vlerë tjetër dëmshpërblimi, të ndryshme nga ajo që ka pranuar me vullnet të lirë nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes dhe/ose deklaratës së pranimi të vlerës.

10. Në rast se shoqëria e sigurimit nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, dhe/ose pala e dëmtuar nuk është dakord me masën e dëmshpërblimit të ofruar nga shoqëria e sigurimit dhe/ose pala e dëmtuar nuk është dakord me shkaqet e refuzimit të dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit, vetëm në këto raste pala e dëmtuar ka të drejtë të ngrejë padi civile kundër shoqërisë së sigurimit.

11. Afatet sipas pikës 1 të këtij neni dhe e drejta e palës së dëmtuar për përfitimin e interesit të



pagueshëm për mosrespektim të këtyre afateve nuk zbatohen për rastet e aksidenteve ku janë përfshirë mjetet motorike të regjistruara jashtë shtetit dhe të pajisura me karton jeshil, si dhe për rastet e aksidenteve ku janë përfshirë mjete motorike të pasiguruar dhe të painedentifikuar sipas nenit 41 të këtij ligji.

12. Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, në rast pranimit të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj. Siguruesi përgjegjës, gjithashtu, ka të drejtë të publikojë në faqen e internetit ose nëpërmjet programeve analoge listën e përfituesve të dëmshpërblimit dhe t'i ftojë ata të paraqiten pranë zyrave përkatëse për t'u njohur me vlerën e përlogaritur, për ta tërhequr atë nëse e pranojnë dhe për të përmbysur praktikën përkatëse të dëmshpërblimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11

Rregullat e trajtimit të dëmshpërblimit

1. Rregullat, metodologjia e llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në zbatim të këtij ligji, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji miratohen nga Autoriteti dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

2. Autoriteti mbikëqyr funksionimin e sistemit të dëmshpërblimit dhe rregullat e ndjekura nga shoqëritë e sigurimit, për të garantuar mbrojtjen e të siguruarve, kryerjen me korrektësi të procedurave të dëmshpërblimit.

3. Përlogaritja e shumës së dëmshpërblimit kryhet nga një vlerësues i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

4. Vlerësuesi e kryen vlerësimin sipas parimeve dhe metodologjisë së miratuar nga Autoriteti duke zbatuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi.

Neni 12

Dëmshpërblimi i kërkesave me vlerë të vogël

Përfshihet nga parashikimi i shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 10, kërkesat për dëmshpërblim për dëme ndaj pronës me vlerë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë do të paguhet nga shoqëritë e sigurimit brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve

kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Neni 13

Rimbursimi i shoqërisë së sigurimit

1. Shoqëria e sigurimit, e cila në përputhje me këtë ligj ka dëmshpërbllyer palën e dëmtuar, por sipas këtij ligji nuk ka qenë përgjegjëse, ka të drejtë të kërkojë rimbursim nga personi përgjegjës për dëmin deri në shumën e paguar, interesin e paguar dhe koston e procedurave.

2. Sigurimi motorik për përgjegjësinë e palës së tretë, gjithashtu, do të përfshijë, sipas këtij ligji, dëmet e shkaktuara nga drejtimi i mjetit nga një person i paautorizuar.

3. Parashikimet e pikës 1 të këtij neni zbatohen në të njëjtën mënyrë në rast se Byroja është përgjegjëse për trajtimin e dëmeve sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 14

Raporti Evropian i Aksidenteve

1. Shoqëria e sigurimit është e detyruar që së bashku me policën e sigurimit t'i dorëzojë të siguruarit Raportin Evropian të Aksidenteve sipas formularit të miratuar nga Autoriteti.

2. Drejtuesit e mjeteve të përfshirë në një aksident rrugor, për dëmet ndaj pronës në vlerë deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, nëse bien dakord, duhet të plotësojnë, të nënshkruajnë dhe të shkëmbejnë Raportin Evropian të Aksidenteve. Nëse nuk bien dakord, duhet të marrin procesverbalin e konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore.

3. Raporti i nënshkruar nga të dy drejtuesit e mjeteve nënkupton që ngjarja (aksidenti) ka ndodhur sipas rrethanave, modaliteteve dhe pasojave të pasqyruara në formular, përveç rastit kur vërtetohet ndryshe nga shoqëria e sigurimit.

4. Raporti i plotësuar dhe i nënshkruar i bashkëlidhet kërkesës për dëmshpërblim, e cila trajtohet nga shoqëria e sigurimit sipas afateve të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji. Detyrimi i shoqërisë së sigurimit shuhet me pagimin e vlerës së dëmshpërblimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, për të cilën është nënshkruar Raporti Evropian i Aksidentit.



5. Drejtuesit e mjeteve, të përfshirë në një aksident rrugor, për të gjitha dëmet në vlerë mbi 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, duhet të marrin procesverbalin e konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore.

KREU II KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

Neni 15

Kontrata e sigurimit të detyrueshëm

1. Siguruesi është i detyruar të lidhë kontratën e sigurimit të detyrueshëm në përputhje me parashikimet e këtij ligji, me kushtet e sigurimit dhe nivelin e primeve të sigurimit të aplikueshme në kohën kur është lidhur kontrata.

2. Siguruesi nuk mund të refuzojë kërkesën për të lidhur kontratën e sigurimit kur aplikuesi pranon kushtet sipas të cilave siguruesi e ofron këtë sigurim.

3. Për mjetet në transportin publik, siguruesi nuk lëshon kontratën e sigurimit të përgjegjësisë së pronarit nëse pronari i mjetit nuk zotëron edhe policën e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, sipas përcaktimeve të nenit 17 të këtij ligji.

4. Kontrata e sigurimit duhet të përmbajë:

- a) emrat dhe adresat e palëve;
- b) objektin e kontratës;
- c) rrezikun e mbuluar dhe përjashtimet ose kufizime të tjera të mbulimit;
- ç) mënyrën dhe rastet e rinovimit, të ndryshimit të kontratës;
- d) mënyrat e zgjidhjes së plotë apo të pjesshme të kontratës;
- dh) detyrimet e palëve dhe pasojat juridike të mospërbushjes së tyre;
- e) mënyrën dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit, si dhe pasojat e mospagimit ose pagimit të pasaktë nga ana e shoqërisë së sigurimit;
- ë) primin e sigurimit;
- f) kushtet e pagesës së primit dhe pasojat e mospagimit;
- g) në rastin e nënshkrimit të kontratës nga ndërmjetësi, emrin, adresën dhe të dhëna të licencës së ndërmjetësit, si dhe kodin e identifikimit të tij;

gj) datën dhe vendin e nënshkrimit të kontratës;

h) detyrimet e të siguruarit në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguruar dhe barra e tij e provës;

i) trajtimin e shërbimeve të siguruesit;

j) trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim për rastet që trajtohen nga Byroja dhe shoqëritë e sigurimit, si ent kompensues.

5. Kushtet e kontratës së sigurimit përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet ndërmjet palëve kontraktuese, përveç atyre të parashikuara në këtë ligj.

6. Kontrata e sigurimit të detyrueshëm bëhet me shkrim në formën e policës së sigurimit dhe është e vlefshme edhe në rastet kur është në formën e një dokumenti elektronik në përputhje me dispozitat e ligjit për nënshkrimin elektronik dhe për dokumentin elektronik.

Neni 16

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria territoriale

1. Polica e sigurimit hyn në fuqi duke filluar saktësisht në orën 24:00 të ditës së përcaktuar në policën e sigurimit si datë e fillimit të mbulimit, me pagesën e plotë të primit dhe nënshkrimit të kontratës midis siguruesit dhe të siguruarit, kur nuk është përcaktuar ndryshe në kontratën e sigurimit.

2. Polica e sigurimit përfundon në orën 24:00 të datës së mbarimit të përcaktuar në policën e sigurimit.

3. Kontrata për sigurimin e detyrueshëm, referuar shkronjave “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, mbulon dëmet ose humbjet e ndodhura në Republikën e Shqipërisë.

4. Kontrata për sigurimin e detyrueshëm, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, mbulon dëmet e ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë dëmet e ndodhura në territoret e vendeve anëtare të sistemit të kartonit jeshil, kur nuk është parashikuar ndryshe.



KREU III SIGURIMI I PASAGJERËVE NGA AKSIDENTET NË TRANSPORTIN PUBLIK

Neni 17

Detyrimi për lidhjen e kontratës së sigurimit

1. Pronarët e mjeteve të transportit publik të pasagjerëve janë të detyruar të lidhin kontratë për sigurimin e aksidenteve të pasagjerëve në transportin publik.

2. Kontrata e parashikuar në pikën 1 të këtij neni lidhet nga pronarët:

a) e autobusëve urbanë, interurbanë dhe për transport publik ndërkombëtar, përfshirë edhe rastet kur merren me qira;

b) e autobusëve të transportit të punëtorëve dhe autobusëve të shoqërive turistike;

c) e taksive dhe makinave me qira kur jepen së bashku me drejtuesin;

ç) e të gjitha tipave të mjeteve lundruese detare, lumore dhe liqenore, përfshirë tragetet për transportin e pasagjerëve në linja të rregullta dhe transportin e turistëve, si dhe të mjeteve lundruese pa motor;

d) e të gjitha tipave të mjeteve, të parashikuara në shkronjën “ç” të kësaj pike, të dhëna me qira së bashku me të paktën një anëtar ekuipazhi;

dh) e teleferikëve dhe të mjeteve të transportit mbi shina, përfshirë trenat, tramvajin, metronë, si dhe të mjeteve të tjera, të cilat lëvizin mbi shina;

e) e të gjitha mjeteve të tjera të transportit, pavarësisht nga fuqia, të përdorura për transportin publik me pagesë të pasagjerëve;

ë) e avionëve të përdorur për transportin publik ajror të pasagjerëve;

f) e mjeteve motorike që përdoren për transportin e fëmijëve dhe nxënësve me destinacion kopshtet dhe shkollat.

3. Autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të sigurojnë përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 18

Pasagjerët në një mjet transporti publik

1. Pasagjerë janë personat që udhëtojnë me njërin nga mjetet e transportit të destinuara për transportin publik, pavarësisht nëse kanë blerë një biletë, përfshirë personat që kanë të drejtë të

udhëtojnë pa pagesë, si dhe personat të cilët ndodhen në territorin e stacionit, të molit, portit, aeroportit ose pranë mjeteve të transportit, para se të hipin ose janë duke zbritur, të cilët kanë qëllim të udhëtojnë ose që kanë udhëtuar me njërin nga mjetet e transportit, me përjashtim të personave të punësuar në mjetin e transportit.

2. Personat që gjenden në avion, në shkallë ose në kabinë pa autorizimin e pronarit të avionit ose të ekuipazhit, nuk vlerësohen si pasagjerë sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 19

Përgjegjësia e shoqërisë së sigurimit dhe shuma e siguruar

1. Detyrimi i shoqërisë së sigurimit, që rrjedh nga kontrata e sigurimit, përfaqësohet nga kufijtë minimalë të mbulimit të vlefshëm në ditën e aksidentit, përveç rastit kur në kontratën e sigurimit përcaktohet një vlerë më e lartë.

2. Minimumi i shumës së siguruar për çdo pasagjer të mbuluar nga kontrata e sigurimit, sipas nenit 17 të këtij ligji, përcaktohet si më poshtë:

a) 2 000 000 (dy milionë) lekë në rast vdekjeje;

b) 4 000 000 (katër milionë) lekë në rast paaftësie të përhershme për punë;

c) 1 000 000 (një milion) lekë në rast paaftësie të përkohshme për punë dhe trajtimet mjekësore.

3. Ky sigurim mbulon vdekjen dhe dëmtimet trupore të shkaktuara pasagjerit nga apo si pasojë e:

a) defekteve teknike që çojnë në humbjen e kontrollit mbi mjetin, defekte të cilat ndodhin jo për faj të pronarit apo drejtuesit të mjetit të transportit urban;

b) rënies së objekteve të jashtme mbi mjetin motorik gjatë përdorimit të tij, qëndrimit në stacion apo gjatë qarkullimit;

c) dëmtimeve aksidentale të shkaktuara nga grumbullime masive, akte të dhunshme që mund të kenë motiv politik ose social, si atentate, sabotime, akte terroriste, dëmtime, zjarrvënien e qëllimshme, ngjarje ose shpërthime në objektet e ndryshme që ndodhen jashtë mjetit të transportit publik me kusht që ai të mos jetë pjesëmarrës aktiv në ato ngjarje;

ç) frenimit të papritur, plasjes së gomës, devijimeve të lëvizjes si rezultat i një shpërthimi apo shmangieje të menjëhershme të detyruar që



çon deri në përmbyshjen e mjetit të transportit publik;

d) shpërthimit që ndodh jashtë mjetit të transportit publik;

dh) çdo ngjarjeje tjetër që ndodh jo për faj të drejtuesit/pronarit të mjetit të transportit publik dhe nuk mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësive të pronarit të mjetit.

4. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të zbatojë parashikimet e nenit 10 të këtij ligji për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

Neni 20

E drejta për dëmshpërblim

1. Pasagjeri ose përfituesi ka të drejtë, sipas kushteve të kontratës së sigurimit, të kërkojë te shoqëria e sigurimit me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit që të paguajë dëmshpërblimin.

2. Pronari i mjetit të transportit publik vendos në një vend të dukshëm të mjetit të transportit publik emrin e shoqërisë së sigurimit të përcaktuar në kontratën e sigurimit, si dhe të drejtën e pasagjerit për të përfutur nga kjo kontratë.

KREU IV

SIGURIMI I DETYRUESHËM I PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK PËR DËMET QË U SHKAKTOHEN PALËVE TË TRETA NGA PËRDORIMI I KËTIJ MJETI

Neni 21

Mbulimi në sigurim

1. Pronari i mjetit motorik detyrohet të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësive për dëmet që mund t'u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, me pasoje dëmtimin e pronës, vdekjen, dëmtimet trupore dhe përkeqësimin e shëndetit.

2. Sigurimi nga përgjegjësia për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga pronari i mjeteve të transportit duhet të mbulojë, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me këtë ligj, dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta nga mjetet e transportit, pavarësisht se kush ishte drejtues i mjetit.

3. Shoqëria e sigurimit përfshin në kontratën e sigurimit të gjitha rastet e mbulimit të parashikuara në këtë ligj.

4. Kontrata e sigurimit mbulon edhe dëmet ndaj personit dhe pronës që mund t'u shkaktohen këmbësorëve, çiklistëve, si dhe përdoruesve të mjeteve jomotorike që lëvizin në rrugë.

5. Përgjegjësia e pronarit të mjetit motorik zbatohet për dëmet e shkaktuara si nga mjeti tërheqës edhe nga mjeti i tërhequr (rimorkio).

6. Pronarët e të dyja mjeteve janë bashkërisht përgjegjës në masë të njëjtë për dëmet ndaj palëve të treta, në rastet e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i mjetit tërheqës apo i mjetit të tërhequr kur këto mjete janë të lidhura në një tërësi integrale ose kur aksidenti ndodh nga shpëputja e rimorkios nga mjeti tërheqës. Në këto raste pala e dëmtuar mund të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te siguruesi i mjetit tërheqës ose te siguruesi i rimorkios. Shoqëria e sigurimit që paguan dëmet e palëve të treta ka të drejtën e rimbursimit të dëmshpërblimit nga siguruesi i mjetit tërheqës apo siguruesi i rimorkios në rast se pala përkatëse e siguruar rezulton përgjegjëse për dëmet, por brenda kufirit të përgjegjësisë të palës së siguruar.

7. Sigurimi i përgjegjësive të drejtuesit të mjetit motorik nuk mbulon dëmet e mallrave, të cilat i ka marrë përsipër t'i transportojë drejtuesi i mjetit shkaktar i aksidentit dhe që ndodhen në mjet në çastin e aksidentit.

8. Me kërkesë të palës së siguruar, shoqëria e sigurimit detyrohet t'i lëshojë asaj konfirmim për të gjitha kërkesat për dëmshpërblim që shoqëria e sigurimit ka marrë nga palët e treta dhe që lidhen me sigurimin e përgjegjësive të palës së siguruar.

9. Konfirmimi, sipas pikës 8 të këtij neni, duhet të mbulojë një periudhë të paktën 5-vjeçare dhe të lëshohet nga shoqëria e sigurimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës nga pala e siguruar. Kur pala e siguruar ka me shoqërinë e sigurimit një marrëdhënie më pak se 5-vjeçare, konfirmimi i jepet për të gjithë periudhën e siguruar.

Neni 22

Përgjegjësi nga mbulimi në sigurim

1. Bazuar në sigurimin e përgjegjësive të pronarit të mjetit motorik, nuk kanë të drejtën e dëmshpërblimit palët e mëposhtme:

a) drejtuesi i mjetit, shkaktar i aksidentit, përfshirë këtu trashëgimtarët e tij ligjorë dhe të



afërmit e tij, për dëme që i shkaktohen këtij drejtuesi;

b) çdo bashkudhëtar që ndodhet me vullnetin e tij në mjetin motorik shkaktar të aksidentit, të drejtuar nga një drejtues i paautorizuar, kur provohet se personi që ndodhet në mjet ishte në dijeni të këtyre rrethanave;

c) çdo bashkudhëtar që ndodhet me vullnetin e tij në një mjet të pasiguruar, shkaktar të aksidentit, kur provohet se personi ishte në dijeni të kësaj rrethane;

ç) personi, i cili ka përvetësuar mjetin motorik në mënyrë të kundërligjshme dhe është dëmtuar gjatë përdorimit të këtij mjeti;

d) personi i dëmtuar në këto raste:

i. për shkak të përdorimit të një mjeti në ngjarje sportive në rrugë apo pjesë rrugësh, të palejuara për drejtim të mjetit, për arritjen e shpejtësive mesatarisht të larta ose për t'u stërvitur për gara;

ii. për shkak të pasojave të energjisë bërthamore gjatë transportit të materialeve radioaktive;

iii. për shkak të veprimeve të luftës, revoltave ose akteve terroriste, me kusht që shoqëria e sigurimit të provojë se dëmi është shkaktuar nga ngjarje të tilla.

Neni 23

Humbja e së drejtës së mbulimit në sigurim

1. I siguruari i humbet të drejtat nga mbulimi në sigurim kur:

a) drejtuesi nuk e përdor mjetin në përputhje me qëllimin për të cilin ai është i destinuar të përdoret;

b) drejtuesi nuk ka leje të vlefshme të drejtimit të mjetit motorik, sipas kategorisë apo tipit të mjetit, përveç rasteve të përdorimit gjatë mësimave të drejtimit të mjetit, kur ky drejtohet nga kandidati drejtues sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimave;

c) drejtuesit të mjetit motorik i është pezulluar leja e drejtimit, i është ndaluar të drejtoshë tipin dhe kategorinë e mjetit ose i është ndaluar përdorimi i lejes së drejtimit, të lëshuar nga një vend tjetër për në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ç) drejtuesi drejton mjetin motorik nën ndikimin e alkoolit mbi kufirin e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psikoaktive;

d) drejtuesi e shkaktonte dëmin qëllimisht;

dh) aksidenti ndodh për shkak të defekteve teknike të mjetit, për të cilat drejtuesi ka qenë në dijeni.

2. Humbja e të drejtave që rrjedhin nga sigurimi, siç përcaktohen në shkronjat “a” deri në “dh” të pikës 1 të këtij neni, nuk kufizon të drejtat e palëve të treta për të paraqitur kërkesën për dëmshpërblim të siguruesi përgjegjës.

3. Shoqëria e sigurimit, që sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni ka paguar dëmet të pala e dëmtuar, ka të drejtë të rimbursojë të gjithë masën e paguar për dëmet, interesat dhe shpenzimet nga personi përgjegjës për dëmet.

Neni 24

Dëmshpërblimi për dëmin e shkaktuar nga personi i paautorizuar

1. Kur dëmi është shkaktuar nga drejtimi i paautorizuar i mjetit motorik, pala e dëmtuar mund t'i drejtohet për dëmshpërblim siguruesit përgjegjës, përveç rastit të përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji.

2. Shoqëria e sigurimit, që bën dëmshpërblimin, ka të drejtë të rimbursojë nga personi përgjegjës për dëmin të gjithë vlerën e paguar për dëmin deri në shumën e paguar, interesin e paguar dhe koston e procedurave.

Neni 25

Përgjegjësia e shoqërisë së sigurimit dhe shuma e siguruar

1. Detyrimi i shoqërisë së sigurimit, që rrjedh nga kontrata e sigurimit e përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji, përfaqësohet nga kufijtë minimalë të mbulimit të vlefshëm në ditën e aksidentit, përveç rastit kur në kontratën e sigurimit përcaktohet një vlerë më e lartë.

2. Kufiri minimal i përgjegjësisë, që mbulohet nga kontrata e sigurimit sipas pikës 1 të këtij neni, për dëme të shkaktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë është si më poshtë:

a) për dëme pasurore dhe jopasurore, me pasojë vdekjen, dëmtime shëndetësore dhe përkeqësime të shëndetit, të shkaktuara nga një aksident ose seri aksidentesh të ardhura nga një ngjarje sigurimi për:

i. autobusë dhe kamionë, përfshirë rimorkiot, 150 000 000 lekë;



ii. mjete që transportojnë lëndë të rrezikshme 200 000 000 lekë;

iii. mjete të tjera, përfshirë mjetet e paidentifikuara, 55 000 000 lekë.

b) për dëme të lidhura me dëmtimin ose shkatërrimin e pronës nga një ngjarje:

i. për autobusë dhe kamionë, përfshirë rimorkiot, 20 000 000 lekë;

ii. për mjete që transportojnë lëndë të rrezikshme 20 000 000 lekë;

iii. për mjete të tjera, përfshirë mjetet e paidentifikuara, 15 000 000 lekë.

3. Brenda kufijve minimalë të përgjegjesisë, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, vlera e dëmit do të llogaritet:

a) në rastin e dëmeve me pasojë paaftësi të përhershme për punë, kur vërtetohet humbja e të ardhurave, përfitimi llogaritet si produkt i të ardhurave vjetore neto me koeficientin e shumës së kapitalizuar, moshës së daljes në pension dhe humbjes së aftësisë për punë. Kur i/e dëmtuari/a ka qenë në marrëdhënie pune/i vetëpunësuar do të referohet në mesataren e të ardhurave neto për 3 vitet e fundit, ndërsa kur nuk ka qenë në marrëdhënie pune në kohën e ngjarjes do të referohet në pagën minimale zyrtare bruto të vendbanimit në kohën e ngjarjes.

b) në rastet e dëmeve me pasojë vdekje, dëmi pasuror do të llogaritet si në rastin e paaftësisë së plotë të përhershme me ndryshimin që nga të ardhurat sipas shkronjës “a” të këtij neni të zbriten të ardhurat për nevojat e vetë personit, të cilat varen nga numri i personave në familje.

c) në rastet e dëmeve me pasojë paaftësinë e përkohshme, humbja financiare përbën pjesën e papaguar të pagës për kohën e paaftësisë, ndërsa kur i/e dëmtuari/a nuk është në marrëdhënie pune do të referohet në pagën minimale zyrtare bruto.

4. Brenda kufijve minimalë të përgjegjesisë, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, dëmet jopasurore ndaj personit, të shkaktuara nga një ngjarje e vetme, përbëhen nga format e mëposhtme dhe nuk mund të tejkalojnë limitet:

a) vlera e dëmit biologjik për çdo person të dëmtuar do të jetë jo më shumë se 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë për çdo 10% të shkallës së paaftësisë së përhershme, të pjesshme ose të plotë. Shuma e përfitimit e parashikuar në këtë pikë duhet të bazohet në moshën dhe shkallën e paaftësisë së të dëmtuarit;

b) vlera e dëmit moral për çdo person të dëmtuar me pasojë paaftësi të përhershme për punë është nga 3/4 deri në 3/2 e dëmit biologjik sipas shkronjës “a” të pikës 4 të këtij neni;

c) vlera e dëmit ekzistencial për çdo person të dëmtuar me pasojë paaftësi të përhershme për punë është nga 3/4 deri në 3/2 e dëmit biologjik sipas shkronjës “a” të pikës 4 të këtij neni;

ç) vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët e të dëmtuarit/ës, prind/fëmijë/bashkëshort, do të jetë jo më shumë se 1/5 e përfitimit të dëmtuarit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë sipas shkronjës “b” të kësaj pike dhe për secilin nga familjarët vëlla/motër vlera e përfitimit do të jetë jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë;

d) vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët e të dëmtuarit/ës, prind/fëmijë/bashkëshort, do të jetë jo më shumë se 1/5 e përfitimit të dëmtuarit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë sipas shkronjës “c” të kësaj pike dhe për secilin nga familjarët vëlla/motër vlera e përfitimit jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë;

dh) vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, prind/fëmijë/bashkëshort, për vdekjen e të afërmit do të jetë jo më shumë se 220 000 (dyqind e njëzet mijë) lekë dhe për secilin nga familjarët vëlla/motër vlera e përfitimit është jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë;

e) vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, prind/fëmijë/bashkëshort, për vdekjen e të afërmit do të jetë jo më shumë se 220 000 (dyqind e njëzet mijë) lekë dhe për secilin nga familjarët vëlla/motër vlera e përfitimit është jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë;

ë) vlera e dëmit moral për çdo person të dëmtuar është jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo muaj paaftësi të përkohshme;

f) vlera e dëmit ekzistencial për çdo person të dëmtuar është jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo muaj paaftësi të përkohshme.



5. Kufiri minimal i përgjegjësive për çdo person të dëmtuar në një ngjarje sigurimi, sipas shkronjës “a” të pikës 2 dhe pikës 4 të këtij neni, është 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë.

6. Në rast se ka disa palë të dëmtuara nga një ngjarje sigurimi dhe vlera totale e dëmshpërblimit për dëmin ndaj personit, si dhe vlera totale e dëmshpërblimit për dëmin ndaj pronës tejkalon shumat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, shuma e dëmshpërblimit dhe të drejtat e palëve të dëmtuara ndaj shoqërisë së sigurimit zvogëlohen në mënyrë përpjesëtimore për secilën figurë të dëmit ndërmjet të gjithë të dëmtuarve deri në përfundim të gjithë shumës së siguruar sipas kontratës së sigurimit.

7. Shoqëria e sigurimit, që i ka paguar një pale të dëmtuar një shumë më të madhe se shuma e duhur, që rezulton nga zvogëlimi përpjestimor i dëmshpërblimit, pasi, pavarësisht nga masat e marra, nuk mund të parashikohej që kishte palë të tjera të dëmtuara, është përgjegjëse ndaj palëve të tjera deri në plotësimin e të gjithë shumës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

8. Kufiri minimal i mbulimit në sigurimin karton jeshil përcaktohet në ligjet përkatëse të vendit anëtar të sistemit të kartonit jeshil, ku ndodh aksidenti.

9. Për kontratat e lidhura nga data 1 janar 2022 deri në datën 31 dhjetor 2026, kufiri minimal i përgjegjësive i përcaktuar në këtë nen do të rritet:

a) 4 000 000 (katër milionë) lekë çdo vit për mjetet e përcaktuara në nëndarjen “iii” të shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni;

b) 2 000 000 (dy milionë) lekë çdo vit për çdo person sipas pikës 5 të këtij neni.

10. Për kontratat e lidhura nga data 1 janar 2027 dhe në vijim, kufiri minimal i përgjegjësive është i njëjtë me kufirin minimal të përgjegjësive së kontratave të lidhura në vitin 2026.

Neni 26

Ndryshimi i pronësisë së mjetit

1. Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit i kalojnë pronarit të ri dhe vlejnë deri në përfundimin e kontratës së sigurimit, përfshirë këtu edhe të drejtat e detyrimit e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji.

2. Pronari i ri, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, detyrohet të njoftojë shoqërinë e sigurimit për ndryshimin e pronësisë së mjetit dhe pasqyrimin e këtij ndryshimi në kontratën e sigurimit.

Neni 27

Sigurimi i mjetit motorik me regjistrim të huaj

1. Drejtuesi i mjetit motorik, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet me regjistrim të huaj, duhet të jetë i pajisur me një nga dokumentet e mëposhtme:

a) karton jeshil të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) sigurim kufitar të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, që mbulon periudhën e qëndrimit të tij, por jo më pak se 15 ditë kalendarike;

c) dokument tjetër të vlefshëm, që vërteton ekzistencën e sigurimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta, në ato raste kur ka një marrëveshje të veçantë dypalëshe për mjetet me targë regjistrimi të vendit tjetër, nënshkruar të kësaj marrëveshjeje.

2. Për njohjen e vlefshmërisë së dokumenteve ndërkombëtare të sigurimit, Byroja njofton paraprakisht autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar.

3. Kur drejtuesi i mjetit nuk ka dokumentet sipas pikës 1 të këtij neni, ai nuk lejohet të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar janë të detyruara të kontrollojnë përmbushjen e kërkesave të këtij neni.

5. Kur personat e autorizuar për kontrollin e trafikut vërejnë gjatë kontrollit rutinë të trafikut se drejtuesi i mjetit nuk ka dokument ndërkombëtar të vlefshëm, ata ndalojnë qarkullimin e mëtejshëm të mjetit motorik dhe urdhërojnë lidhjen e kontratës kufitare për sigurimin e përgjegjësive që rrjedh nga përdorimi i mjetit motorik.

6. Për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik me regjistrim të huaj, i cili nuk ka dokument të sigurimit ndërkombëtar të vlefshëm dhe as kontratë të sigurimit kufitar, zbatohen parashikimet e nenit 44 të këtij ligji.



Neni 28

E drejta për dëmshpërblim nga përdorimi i mjetit motorik me karton jeshil

1. Pala e dëmtuar së cilës i është shkaktuar dëm në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një mjet motorik me regjistrim të huaj dhe me certifikatë ndërkombëtare të sigurimit, sipas pikës 1 të nenit 27 të këtij ligji, ka të drejtë t'i kërkojë Byrosë dëmshpërblim.

2. Byroja garanton dëmshpërblimin sipas shumave të përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji.

3. Byroja mund të delegojë shqyrtimin dhe pagesën e një dëmi të tillë anëtarëve të saj ose një korrespondenti të emëruar nga Byroja, të cilët janë të detyruar ta trajtojnë dëmin, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë nga përdorimi i mjeteve motorike.

4. Kriteret që duhet të plotësojë një strukturë e specializuar si korrespondent për trajtimin e dëmeve të kartonit jeshil janë:

a) të ketë kapital financiar në vlerën jo më të vogël se 3 000 000 (tre milionë) euro, e cila duhet të jetë e bllokuar në formën e garancisë në një nga bankat e nivelit të dytë;

b) të jetë i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare si vlerësues i dëmeve shëndetësore dhe materiale;

c) të ketë eksperiencë jo më pak se 10 vjet si trajtues dëmsh, i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 29

E drejta e dëmshpërblimit në sigurimin kufitar

1. Pala e dëmtuar së cilës i është shkaktuar dëm nga përdorimi i një mjeti motorik me regjistrim të huaj, i siguruar nga shoqëri sigurimi vendase, ka të drejtën të kërkojë dëmshpërblimin të shoqëria përgjegjëse e sigurimit, e cila ka lëshuar kontratën e sigurimit.

2. Pala e dëmtuar ka të drejtën të kërkojë dëmshpërblim brenda kufijve të përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji.

3. Kur pala e dëmtuar kërkon dëmshpërblim të shoqëria e sigurimit që ka lëshuar policën e sigurimit, sipas pikës 1 të këtij neni, zbatohen parashikimet e neneve 9, 10 e 13 të këtij ligji.

Neni 30

Kërkesa për rimbursimin e mbajtësit të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor

1. Shoqëria e sigurimit detyrohet të kompensojë dëmet e institucioneve që mbulojnë sigurimet e shëndetit, të pensionit, të paafësive brenda kufijve të përgjegjësisë të të siguruarve të tyre dhe brenda kufijve të përcaktuar në kontratën e sigurimit.

2. Dëme sipas pikës 1 të këtij neni vlerësohen shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet e tjera të nevojshme, që kryhen në përputhje me ligjet për sigurimin e shëndetit, përfshirë edhe një masë përpjesëtimore të pensionit të palës së dëmtuar ose anëtarëve të familjes së tij.

3. Masa përpjesëtimore e pensionit përcaktohet në përputhje me ligjin për sigurimet shoqërore, si diferencë ndërmjet pensionit të paafësisë, të përcaktuar me vendim të ISSH-së, dhe pensionit të paafësisë, që përcaktohet në rast aksidenti në punë.

4. Parashikimet e trajtuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni zbatohen përkatësisht edhe në kompensimin e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare të shëndetit, të pensionit, të jetës ose sigurimeve të tjera të ngjashme me to.

KREU V

QENDRA E INFORMACIONIT TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME

Neni 31

Qendra e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme dhe lloji i të dhënave që duhet të administrojë

1. Për dhënien e statistikave të besueshme, standardizimin e praktikave, shmangien e rasteve të mashtrimit dhe dëmshpërblimin e palës së dëmtuar në kohën dhe në masën e duhur krijohet Qendra e Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, e cila:

a) krijon një bazë elektronike për ruajtjen e të dhënave të përfuara nga shoqëritë e sigurimeve, që lidhen me të gjitha llojet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit;

b) mbledh dhe ruan të dhënat e mjeteve motorike, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat i vihen në dispozicion nga autoritetet përkatëse, duke i lidhur këto të dhëna me të dhënat e përfuara sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni;



c) mbledh dhe ruan të dhëna nga kontratat për të gjitha llojet e sigurimit të detyrueshëm, përfshirë certifikatat e kartonit jeshil, kontratat e sigurimit kufitar. Të dhënat përmbajnë numrin e kontratës, emrin e siguruesit, emrin e të siguruarit, datën e fillimit dhe të mbarimit të kontratës, numrin e regjistrimit të makinës, si dhe të dhëna të tjera, sipas rregullave të miratuara nga Autoriteti;

ç) mbledh dhe ruan të dhëna për shoqëritë e sigurimit që ofrojnë sigurim të detyrueshëm, si dhe të dhëna në lidhje me emrin dhe adresat e përfaqësuesve të trajtimit të dëmeve të këtyre shoqërive në çdo vend;

d) mbledh dhe ruan nga shoqëritë e sigurimit të dhëna për dëmet për të gjitha llojet e sigurimit të detyrueshëm, të përditësuara, por jo më vonë se një ditë kalendarike nga përfitimi i të dhënës;

dh) mbledh dhe ruan nga Byroja Shqiptare e Sigurimit të dhëna për dëmet sipas neneve 41 dhe 43 të këtij ligji, të përditësuara, por jo më vonë se një ditë kalendarike nga përfitimi i të dhënës;

e) mbledh dhe ruan të dhëna për subjektet që veprojnë në transportin publik të pasagjerëve, të cilët kanë marrë licencë për këtë transport, të vëna në dispozicion nga autoritetet përkatëse;

ë) mbledh dhe ruan të dhënat për mjetet motorike, të përjashtuara nga detyrimi për sigurim të detyrueshëm motorik të përgjegjësisë ndaj palëve të treta, si dhe të dhëna për autoritetet përgjegjëse për pagesën e dëmeve, që shkaktohen nga këto mjete motorike. Të dhënat sipas kësaj pike përfitohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 5 të nenit 32 të këtij ligji.

2. Qendra e Informacionit, bazuar në të dhënat e administruara, u dërgon njoftim të gjithë pronarëve të mjeteve të transportit duke i informuar rreth mbarimit të policës së sigurimit të detyrueshëm sipas parashikimeve të këtij ligji, duke u dhënë atyre një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike për të përfunduar lidhjen e kontratës së sigurimit.

3. Qendra e Informacionit me kalimin e afatit 15-ditor sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, nëse mjeti nuk ka sigurim të detyrueshëm të përgjegjësisë ndaj palëve të treta të vlefshëm, njofton menjëherë organet e ngarkuara nga ligji për regjistrimin e mjeteve dhe ato të kontrollit të qarkullimit rrugor për mjetet e pasiguruara për ekzekutimin e masave administrative të parashikuara në pikën 3 të nenit 4 të këtij ligji.

4. Shoqëritë e sigurimit detyrohen të furnizojnë Qendrën e Informacionit me të dhënat e përcaktuara në këtë nen, në kohë reale për çdo shitje të kontratave të sigurimit të detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur Autoriteti vendos ndryshe. Autoriteti miraton rregullore për mënyrën e funksionimit të Qendrës së Informacionit dhe për mënyrën e procedurave të raportimit dhe njoftimit të të dhënave, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Qendra e Informacionit mbledh, përpunon e i ruan këto të dhëna dhe ua vë në dispozicion personave të autorizuar sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Periudha kohore që duhet të ruhen të dhënat e përmendura në këtë nen është minimalisht 7 (shtatë) vjet nga data e përfundimit të regjistrimit të mjetit motorik ose pas përfundimit të vlefshmërisë së policës të sigurimit.

6. Në rastin e përpunimit dhe mbledhjes së të dhënave personale zbatohet legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar.

7. Shoqëritë e sigurimit kontribuojnë financiarisht për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Informacionit dhe këto kontribute përdoren për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kësaj qendre. Struktura, veprimtaria e Qendrës së Informacionit dhe masa e kontributit financiar miratohen me rregullore të Autoritetit.

8. Autoriteti me vendim mund të autorizojë subjekte të specializuara për operimin dhe mirëmbajtjen e Qendrës së Informacionit. Autoriteti miraton rregulla dhe procedura për kriteret që duhet të përmbushin këto subjekte për t'u autorizuar nga Autoriteti.

Neni 32

Dhënia e informacionit palës së dëmtuar

1. Qendra e Informacionit duhet t'u mundësojë dhënien dhe përdorimin e të dhënave, të grumbulluara sipas këtij ligji, të gjitha palëve të dëmtuara dhe pjesëmarrësve në një aksident rrugor për një periudhë 7-vjeçare pas aksidentit. Qendra është e detyruar t'i japë palës së dëmtuar, sipas së drejtës që ka për kompensim, këto të dhëna:

a) emrin e shoqërisë, selinë dhe zyrën e regjistruar të siguruesit përgjegjës;

b) numrin e kontratës së sigurimit;



c) emrin dhe adresën e shoqërisë, selinë dhe zyrën e regjistruar të përfaqësuesit të dëmeve në vendin ku jeton pala e dëmtuar.

2. Qendra e Informacionit duhet të japë të dhëna për identitetin dhe adresën e pronarit ose të drejtuesit të mjetit motorik në rastin kur pala e dëmtuar ka një interes të ligjshëm për të.

3. Qendra e Informacionit duhet t'i japë palës së dëmtuar të dhëna për të drejtën për dëmshpërblim, që rrjedh nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet, për emrin dhe selinë e shoqërisë së sigurimit, numrin e kontratës së sigurimit, si dhe të dhëna për shoqërinë e sigurimit. Qendra duhet të japë të dhëna për shoqërinë e transportit publik, në rast se pala e dëmtuar ka një interes të ligjshëm për të marrë këtë të dhënë.

4. Për të dhënat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, për kontratat e sigurimit të lidhura jashtë Republikës së Shqipërisë ose për mjetet motorike të regjistruara jashtë Republikës së Shqipërisë, Qendra e Informacionit duhet të kërkojë të dhënat e nevojshme nga qendrat e informacionit në vendet përkatëse. Me kërkesën e qendrave të informacionit të vendeve të huaja, Qendra e Informacionit është e detyruar t'i japë të dhënat që disponon.

5. Kur Qendra e Informacionit nuk ka të dhëna për identitetin ose adresën e personave, sipas pikës 2 të këtij neni, ose për emrin dhe selinë e shoqërisë, sipas pikës 3 të këtij neni, i përfiton të dhënat me anë të një kërkesë të shkruar drejtuar shoqërisë së sigurimit që ka lidhur kontratën e sigurimit ose autoriteteve përgjegjëse për mbajtjen e këtyre të dhënave.

6. Për marrjen e informacionit sipas pikave 1, 2 e 3 të këtij neni, pala e dëmtuar duhet të specifikojë në kërkesën tip datën e saktë, vendin e ndodhjes së rastit të sigurimit, numrin e regjistrimit të mjetit motorik, si dhe informacion plotësues, kur ka të tillë.

7. Qendra e Informacionit është e detyruar të japë informacionin që disponon, të parashikuar sipas këtij neni, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e depozitimit të kërkesës me shkrim nga personi i siguruar.

Neni 33

Dhënia e informacionit nga shoqëria e sigurimit

1. Çdo shoqëri sigurimi, e cila ofron sigurim të detyrueshëm të përgjegjësive për dëmet shkaktuar palëve të treta ose sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, raporton për kontratat e lidhura dhe për ato të cilave u ka përfunduar afati, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga Autoriteti.

2. Shoqëritë e sigurimit, në zbatim të pikës 1 të nenit 31 të këtij ligji, duhet të depozitojnë çdo vit pranë Qendrës së Informacionit një listë të zyrave të përfaqësimit në vendet anëtare dhe informacion për përfaqësuesit e dëmeve, si dhe ta përditësojnë këtë informacion brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e ndryshimit të informacionit.

Neni 34

Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi me autoritetet publike kompetente

1. Autoritetet përgjegjëse për monitorimin e trafikut rrugor, ajror dhe detar të kalimit kufitar për monitorimin e shërbimit doganor dhe administrimin e shërbimeve të transportit rrugor duhet të furnizojnë Qendrën e Informacionit me të dhënat e parashikuara sipas këtij ligji.

2. Qendra e Informacionit ndërvepron me anë të platformës qeveritare të ndërveprimit, nga ku do të merren të dhënat dytësore me institucionet e mëposhtme:

a) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) Regjistri Kombëtar i Mjeteve, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

c) Regjistri Tregtar, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

ç) Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

d) çdo bazë tjetër të dhënash, që mund të ndërveprojë përcaktuar në akte nënligjore plotësuese të këtij ligji.

3. Qendra e Informacionit duhet t'u japë autoriteteve përgjegjëse informacion të përditësuar për:



a) mjetet e transportit, të cilat nuk kanë sigurim të detyrueshëm të përgjegjësisë ndaj palëve të treta, të vlefshëm ose për të cilat ka përfunduar dhe nuk është rinovuar afati i kontratës së sigurimit, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike;

b) subjektet të cilat veprojnë në transportin publik të pasagjerëve, që nuk kanë sigurim të detyrueshëm të aksidenteve të pasagjerëve ose për të cilat ka përfunduar dhe nuk është rinovuar afati i kontratës së sigurimit, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike.

4. Autoritetet përgjegjëse duhet të marrin masa për ndalimin e menjëhershëm të lëvizjes së mjeteve të transportit në kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Format, mënyrat dhe afatet e shkëmbimit të informacionit dhe të bashkëpunimit, sipas këtij neni, përcaktohen me marrëveshje të miratuar nga ministri përgjegjës për punët e brendshme, ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

KREU VI

BYROJA SHQIPTARE E SIGURIMIT, FONDI I GARANCISË DHE FONDI I KOMPENSIMIT

Neni 35

Byroja Shqiptare e Sigurimit

1. Byroja Shqiptare e Sigurimit është person juridik, me seli në Tiranë, e krijuar jo për qëllime fitimi.

2. Anëtar i Byrosë është çdo sigures, i cili është licencuar për të ushtruar veprimtari sipas shkronjave “a” e “b” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji. Siguresi nuk mund të kryejë veprimtaritë e sigurimit të detyrueshëm sipas shkronjave “a” e “b” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji pa qenë anëtar i Byrosë.

3. Byroja Shqiptare e Sigurimit organizohet në dy departamente të pavarura: Departamenti i Kartonit Jeshil dhe Departamenti i Fondit të Kompensimit.

4. Kontributi fillestar i siguresit për anëtarësim në Byro përcaktohet në statutin e Byrosë dhe është i detyrueshëm për t'u paguar në favor të saj.

5. Byroja autorizon anëtarin e saj për të lëshuar karton jeshil pas përmbushjes prej tij të dispozitave ligjore, nënligjore dhe të të gjitha kriterëve të

miratuara nga asambleja e përgjithshme e anëtarëve, në përputhje me rregullat e sistemit të kartonit jeshil.

6. Byroja është përfaqësuese kombëtare në këshillin e byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e kartonit jeshil.

7. Byroja kryen funksionet e entit kompensues për kryerjen e pagesave të parashikuara në nenin 41 të këtij ligji. Fondet e nevojshme për pagesën e dëmshpërblimeve për kompensimet përballohen nga fondi i kompensimit.

8. Organizimi dhe funksionimi i Byrosë përcaktohen në statutin e saj. Buxheti financohet nga të gjithë anëtarët e Byrosë, në mënyrë të barabartë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga miratimi i tij prej Autoritetit.

9. Mbikëqyrja e Byrosë kryhet nga Autoriteti, i cili përcakton me rregullore të veçantë rregullat dhe standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes.

10. Raporti vjetor financiar i Byrosë i nënshtrohet kontrollit dhe vërtetimit ligjor nga shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar, e cila jep opinionin e saj. Për auditimin e Byrosë zbatohen kushtet dhe kriteret e auditimit të shoqërisë së sigurimit.

11. Byroja krijon regjistër elektronik për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të dëmeve sipas parashikimeve të neneve 41 dhe 43 të këtij ligji. Mënyra e funksionimit të regjistrit elektronik dhe procedurat e raportimit të të dhënave nga Byroja dhe shoqëritë e sigurimit përcaktohen me rregullore nga Autoriteti.

Neni 36

Organet drejtuese të Byrosë

1. Organet drejtuese të Byrosë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- b) Bordi i Drejtorëve;
- c) Drejtori Ekzekutiv.

2. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve përbëhet nga përfaqësues të shoqërive të sigurimit, anëtarë të Byrosë. Çdo shoqëri siguri, anëtare e Byrosë, përfaqësohet me një votë në mbledhjet e Asamblesë. Asambleja zgjedh kryetarin, i cili drejton mbledhjen e Asamblesë. Kryetari i Asamblesë zgjidhet me mandat 1-vjeçar sipas sistemit të rotacionit ndërmjet anëtarëve të saj.



3. Bordi i drejtorëve të Byrosë përbëhet nga gjashtë anëtarë, nga të cilët pesë anëtarë me të drejtë vote të propozuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve për një periudhë deri në 4 (katër) vjet, me të drejtë rëmërimi dhe një anëtar pa të drejtë vote të zgjedhur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Bordi i Drejtorëve zgjedh kryetarin e Bordit.

4. Anëtarët e bordit të Byrosë me të drejtë vote dhe drejtori ekzekutiv i Byrosë propozohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Autoriteti miraton ose refuzon anëtarët e Bordit dhe drejtorin ekzekutiv brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të vendimit të asamblesë.

5. Drejtori ekzekutiv i Byrosë zgjidhet për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rëmërimi. Drejtori ekzekutiv i Byrosë merr pjesë në të gjitha mbledhjet e bordit dhe të Asamblesë së Përgjithshme.

6. Anëtarët e bordit dhe drejtori ekzekutiv duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore dhe nënligjore të kualifikimit, përvojës dhe përshtatshmërisë së anëtarit të drejtorisë së një shoqërie sigurimi, sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon veprimtarinë e sigurimit në Shqipëri.

7. Anëtarët e bordit të drejtorëve, si dhe familjarët e tyre nuk mund të jenë palë të lidhura me shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë që auditojnë pasqyrat financiare të Byrosë. Për rastet e konfliktit të interesit anëtarët e bordit u nënshtrohen rregullave sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon veprimtarinë e sigurimit në Shqipëri.

8. Kompetencat, detyrat e organeve drejtuese të Byrosë dhe forma e organizimit të saj përcaktohen në statutin e Byrosë, i cili propozohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve dhe miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 37

Fondi i garancisë dhe fondi për pagesën e dëmeve të kartonit jeshil

1. Fondi i garancisë i kartonit jeshil krijohet dhe administrohet nga Byroja dhe ka për qëllim garantimin e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit jeshil.

2. Çdo anëtar i Byrosë, i autorizuar për të lëshuar karton jeshil, duhet të depozitojë një garanci bankare pranë një banke të nivelit të dytë në Shqipëri, në favor të Byrosë, në shumën që

përcaktohet nga asambleja e anëtarëve, por jo më të vogël se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro.

3. Fondi për pagesën e dëmit të kartonit jeshil mbahet në llogari qëllimore të veçanta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve përcakton çdo vit shumën e këtij fondi.

4. Shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë në sigurimin e detyrueshëm motorik të kartonit jeshil janë të detyruara të kontribuojnë financiarisht në fondin e kartonit jeshil, në përpjesëtim të drejtë me primet e shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm motorik të kartonit jeshil, në vitin e fundit paraardhës.

5. Byroja është e detyruar të njoftojë menjëherë Autoritetin nëse një shoqëri sigurimi anëtare e Byrosë do të veprojë në kundërshtim me detyrimet e parashikuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.

6. Fondi i garancisë së kartonit jeshil përdoret:

a) në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve financiare të një anëtari të Byrosë, përgjegjës për pagesën e dëmshpërblimit, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil;

b) për pagesën e dëmeve të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në një vend anëtar të sistemit të kartonit jeshil, në rastin kur dëmi është shkaktuar nga mjete motorik i regjistruar në Shqipëri, i pajisur me karton jeshil fals për të cilin Byroja është përgjegjëse, sipas rregullave të sistemit të kartonit jeshil;

c) në rast të mbylljes ose falimentimit të një anëtari të Byrosë.

7. Fondi i garancisë së kartonit jeshil nuk përfshihet në llogaritjen e fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit, sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon veprimtarinë e sigurimit në Shqipëri.

Neni 38

Administrimi i fondit të garancisë së kartonit jeshil

1. Byroja i paraqet për miratim Autoritetit rregulloren për administrimin e fondit të garancisë së kartonit jeshil, si dhe rregullat për trajtimin e dëmeve të kartonit jeshil.

2. Byroja paraqet në Autoritet çdo muaj raportin për gjendjen e aktiveve në mbulim të fondit për pagesën e dëmeve të kartonit jeshil.



Neni 39

Trajtimi i dëmeve të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Byroja ndihmon palën e dëmtuar, shtetas ose me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, për trajtimin e kërkesës për kompensimin e dëmit të pësuar gjatë një aksidenti rrugor, i cili ka ndodhur në një vend anëtar të sistemit të kartonit jeshil.

2. Pala e dëmtuar mund të bëjë një kërkesë, sipas pikës 1, të këtij neni, vetëm në rastet kur siguruesi përgjegjës ose përfaqësuesi i tij i dëmeve nuk kanë përmbushur detyrimet.

3. Trajtimi i dëmeve, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe.

Neni 40

Kërkesa për dëmshpërblim

1. Parashikimet e neneve 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij ligji zbatohen në të njëjtën mënyrë nga Byroja dhe shoqëritë e sigurimit për trajtimin e dëmeve, sipas parashikimeve të neneve 41 dhe 43 të këtij ligji.

2. Për ndjekjen e procedurave, trajtimin e dëmeve, kryerjen e pagesave dhe ndjekjen e rimbursimeve nga fondi i kompensimit, Byroja mund të delegojë dhe autorizojë njërin prej anëtarëve të saj.

3. Shoqëritë e sigurimit krijojnë dhe mbajnë provigjone teknike të dëmeve për rastet e përcaktuara në nenet 41, pika 1, dhe 43, pika 1, të këtij ligji. Provigjonet teknike të dëmeve duhet të llogariten nga aktuari i autorizuar.

4. Bazat, metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe raportimi i tyre bëhen në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.

5. Pagesa e detyrimit kundrejt palës së tretë të dëmtuar për dëmin e shkaktuar nga mjeti motorik i pasiguar sipas rasteve të parashikuara në nenet 41 dhe 43 të këtij ligji, përbën titull ekzekutiv, në kuptim të shkronjës “e” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, kundrejt personit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin.

Neni 41

Fondi i kompensimit

1. Fondi i kompensimit administrohet nga Byroja dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve ndaj pronës dhe ndaj personit, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë për:

a) dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike të pasiguruara dhe dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike të paidentifikuara, përjashtuar rastet për të cilat i dëmtuari dëmshpërblehet drejtpërdrejt nga shoqëria e sigurimit, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 43 të këtij ligji;

b) pagesën e dëmshpërblimit ndaj pasagjerit në rastet kur pronari i një mjeti motorik në transportin publik nuk ka lidhur kontratë për sigurimin e pasagjerëve;

c) rastet e likuidimit apo falimentimit të shoqërisë së sigurimit.

2. Vlera minimale e fondit të kompensimit me qëllim pagesën e dëmeve nuk mund të jetë më e vogël se 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë. Kjo vlerë mbahet nga Byroja si fond garancie në një llogari bankare qëllimore në njërin nga bankat e nivelit të dytë dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe investohet vetëm në bono thesari dhe/ose depozita bankare, me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit.

3. Burimet e financimit të fondit të kompensimit do të jenë:

a) kontributet e shoqërive të sigurimit;

b) kontributet shtesë të shoqërive të sigurimit, kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat e dëmeve, objekt i fondit të kompensimit;

c) gjokat e vëna pronarit të mjetit të transportit kur nuk ka lidhur kontratën e sigurimit të detyrueshëm, sipas parashikimeve të Kodit Rrugor;

ç) të ardhurat nga investimet dhe të ardhurat e tjera të fondit të kompensimit;

d) burime të tjera në përputhje me ligjin.

4. Autoriteti, me propozimin e Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve sipas pikës 3 të këtij neni dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja e kontributit.



Neni 42

Pagesa e kontributeve në Fondin e Kompensimit

1. Shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë në sigurimin e detyrueshëm motorik janë të detyruara të kontribuojnë financiarisht çdo vit në fondin e kompensimit sipas nenit 41 të këtij ligji, në përpjesëtim të drejtë me primet e shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm motorik të vitit paraardhës, përjashtuar kartonin jeshil.

2. Autoriteti përcakton me rregullore mënyrën e llogaritjes së fondit të kompensimit, si dhe rastet e prekjes, ndërhyrjes dhe afatet e rivendosjes së vlerës minimale të fondit të kompensimit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 41 të këtij ligji. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të paguajnë kontributet për financimin e fondit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas marrjes së njoftimit nga Byroja. Në rast të mosrespektimit të këtij afati, do të aplikohet interesi i pagueshëm për çdo ditë kalendarike vonesë të barabartë me normat e interesit të bonove të thesarit me afat maturimi 1 (një) vit.

3. Kontributet e fondit mbahen nga Byroja në një nga bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë llogari qëllimore për fondin e kompensimit. Kjo llogari do të titullohet “Fondi i kompensimit” dhe do të shërbejë vetëm për pagesën e dëmeve të fondit të kompensimit.

4. Byroja është e detyruar të njoftojë menjëherë Autoritetin nëse një shoqëri sigurimi vepron në kundërshtim me detyrimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

5. Institucionet që mbulojnë sigurimet e shëndetit, të pensionit dhe të paaftësisë, të cilat kanë kompensuar palën e dëmtuar, si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga mjeti i pasiguruar, i paidentifikuar ose shoqëria e falimentuar, nuk kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim nga Fondi i Kompensimit.

6. Shoqëria e sigurimit nuk ka detyrimin për financimin e fondit të kompensimit për pjesën e këtij fondi, që lidhet me detyrimet e lindura para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Neni 43

Trajtimi dhe pagesa e drejtpërdrejtë nga shoqëria e sigurimit

1. Shoqëritë e sigurimit kryejnë funksionet e entit kompensues si sigurus i drejtpërdrejtë i palës së tretë të dëmtuar për trajtimin dhe pagesën e dëmeve ndaj pronës apo ndaj personit të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë për:

a) dëmet ndaj pronës dhe/ose personit që ndodhet në mjetin motorik të siguruar, shkaktuar nga mjeti motorik i pasiguruar, si dhe/ose personave që ndodhen në mjetin motorik të pasiguruar;

b) dëme ndaj personit që ndodhet në mjetin motorik të siguruar, shkaktuar nga mjeti motorik i paidentifikuar.

2. Përjashtimisht nga parashikimi i pikës 1 të këtij neni, dëmet ndaj pronës dhe/ose personit shkaktuar ndaj mjetit motorik autobus dhe mjetit që transporton lëndë të rrezikshme, trajtohen dhe paguhën nga Byroja Shqiptare e Sigurimit sipas nenit 41 të këtij ligji.

3. Shoqëritë e sigurimit trajtojnë, paguajnë dhe rimbursojnë dëmet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni sipas procedurave dhe afateve të parashikuara në nenet 10, 11 dhe 12 të këtij ligji.

Neni 44

Dëmshpërblimi i dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i një mjeti motorik të pasiguruar

1. Pala e dëmtuar së cilës i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i përgjegjësisë ndaj palës së tretë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga Byroja ose nga shoqëria e sigurimit, sipas neneve 41 dhe 43 të këtij ligji.

2. Në rast dëmsh dhe humbjes, të shkaktuara nga mjete motorike sipas pikës 1 të këtij neni, Byroja ose shoqëria e sigurimit garanton kufijtë e përgjegjësisë, të përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji.

3. Byroja ose shoqëria e sigurimit ka të drejtë të rimbursojë nga personi përgjegjës shumën e paguar, shpenzimet dhe interesat. Në rast të një padie civile për dëmshpërblim, të ngritur nga pala e dëmtuar kundrejt Byrosë ose shoqërisë së sigurimit, shkaktari i dëmit duhet të njoftohet për të marrë pjesë si palë në këtë proces civil.



Neni 45

Dëmshpërblimi ndaj pasagjerit në transportin publik

1. Kur pronari i një mjeti motorik nuk ka lidhur kontratë për sigurimin e pasagjerëve në transportin publik, pasagjeri ose personi përfitues sipas mbulimit të kësaj kontrate, nëse kjo kontratë do të ishte lidhur, ka të drejtë të kërkojë pagesën e shumës së siguruar nga fondi i kompensimit.

2. Byroja ka të drejtë të kërkojë nga personi përgjegjës rimbursimin e shumës së paguar të shpenzimeve dhe të interesit të pagueshëm.

Neni 46

Dëmshpërblimi i dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike të paidentifikuara

1. Pala e dëmtuar drejton kërkesën për dëmshpërblim te Byroja ose shoqëria e sigurimit për dëme të shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike të paidentifikuara.

2. Pala e dëmtuar ka të drejtë të dëmshpërblehet për dëmet ndaj personit, që vijnë si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore ose përkeqësimit të shëndetit, deri në shumën e përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji.

3. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëmet ndaj pronës, që kalon vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, deri në shumën e përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji, duke përfshirë dëmin shkaktuar mjetit motorik. Pala e dëmtuar ka të drejtë të dëmshpërblehet për këto dëme pas pagesës nga ana e Byrosë ose shoqërisë për dëmet ndaj personit nga aksidente me pasojë vdekjen, dëmtimet trupore apo përkeqësimin e shëndetit.

4. Në rast të identifikimit të mëvonshëm të mjetit motorik, shkaktar të aksidentit apo të shoqërisë përgjegjëse të sigurimit, Byroja ose shoqëria e sigurimit ka të drejtë të rimbursohet nga personi përgjegjës ose shoqëria e sigurimit përgjegjëse deri në shumën e paguar për dëmet, shpenzimet dhe interesat.

5. Parashikimet e pikave 1, 2 e 3 të këtij neni zbatohen edhe në rastin kur mjeti motorik rezulton i përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme në çastin e aksidentit.

Neni 47

Dëmshpërblimi i dëmit në rast të likuidimit ose falimentimit të shoqërisë së sigurimit

1. Në rast se shoqëria e sigurimit e licencuar për të ushtruar veprimtari sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 2 ndërpret veprimtarinë, pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te Byroja.

2. Pala e dëmtuar ka të drejtë të dëmshpërblimit deri në shumat e përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji.

3. Në rast të pagesës së dëmeve gjatë kryerjes së procedurave të likuidimit/falimentimit të shoqërisë së sigurimit, Byroja ka të drejtë të rimbursohet nga shoqëria e sigurimit që është nën procedurat ligjore për masën e dëmeve të paguara, shpenzimet dhe interesin e pagueshëm. Për sa kohë zhvillohen procedurat e likuidimit/falimentimit, Byrosë i lind e drejta e kompensimit për të gjitha shumat nga gjendja e shoqërisë së sigurimit.

Neni 48

Administrimi i fondit të kompensimit

1. Byroja i paraqet për miratim Autoritetit rregulloren për administrimin e Fondit të kompensimit.

2. Kontributi i çdo anëtari në fondin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 41 të këtij ligji, afati për derdhjen e kontributit, prekja dhe rivendosja e këtij fondi miratohen me rregullore nga Autoriteti.

3. Byroja paraqet në Autoritet çdo muaj raportin për gjendjen e fondit të kompensimit.

Neni 49

Pasqyrat financiare të Byrosë

1. Byroja paraqet në Autoritet pasqyrat financiare vjetore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

2. Çdo tepriçë e të ardhurave mbi shpenzimet, të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave të Byrosë, do të transferohet në vitin e ardhshëm dhe do të merret parasysh gjatë përcaktimit të shumës së nevojshme për financimin e buxhetit të Byrosë për vitin e ardhshëm.



KREU VII

**SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË SË
PRONARËVE TË MJETEVE LUNDRUESE
PËR DËMIN E SHKAKTUAR PALËVE
TË TRETA**

Neni 50

Detyrimi për të lidhur kontratën e sigurimit

1. Pronari i mjeteve lundruese, me fuqi motorike më të madhe se 15 kw, që sipas rregullave të regjistrimit të mjeteve lundruese duhet të regjistrohet në regjistrin e mjeteve lundruese, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi të përgjegjësisë për dëmet ndaj pronës dhe ndaj personit, të shkaktuara ndaj palëve të treta.

2. Në palët e treta, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk përfshihen personat në bordin e mjetit të vogël lundrues, shkaktarë të dëmit, as personat në mjetin tjetër lundrues ose në bordin e ndonjë mjeti tjetër lundrues.

3. Pronari i mjetit të vogël lundrues të huaj, që hyn në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë, duhet të ketë një kontratë sigurimi të vlefshme për përgjegjësitë ndaj dëmeve, shkaktuar palëve të treta, sipas pikës 1 të këtij neni, përveçse kur ka një garanci tjetër kompensimi për dëmet ose kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për përgjegjësitë e pronarëve të mjeteve të vogla lundruese me motor, gjatë lundrimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

Neni 51

Shuma e sigurimit

1. Detyrimi i shoqërisë së sigurimit për kompensimin e dëmeve, sipas nenit 50 të këtij ligji, është i barabartë me shumën e siguruar, të vlefshme në ditën e ngjarjes së sigurimit, përveç rasteve kur në kontratën e sigurimit është përcaktuar një shumë më e lartë.

2. Shuma minimale e siguruar në kontratën e sigurimit, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, për çdo ngjarje të vetme është 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.

KREU VIII

**SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË SË
PRONARËVE TË AVIONËVE PËR DËMIN
E SHKAKTUAR PALËVE TË TRETA**

Neni 52

Detyrimi për të lidhur kontratën e sigurimit

1. Pronari i avionit të regjistruar në regjistrin shqiptar të avionëve civilë duhet të lidhë një kontratë sigurimi të përgjegjësisë për çdo dëm dhe/ose humbje shkaktuar palëve të treta përgjatë përdorimit të avionit.

2. Kontrata e sigurimit sipas pikës 1 të këtij neni mbulon:

a) dëme shkaktuar palëve të treta me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore dhe dëmtim ose shkatërrim të pasurisë gjatë fluturimit të avionit;

b) dëme shkaktuar pasagjerëve me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore gjatë fluturimit të avionit;

c) dëmtime ose humbje të sendeve personale të pasagjerëve, që janë të vendosura në kabinën e avionit;

ç) dëmtime ose humbje të mallrave në transport (*cargo*) dhe të bagazheve, që kanë kaluar procesin e regjistrimit.

3. Palë e tretë quhet çdo person i ndryshëm nga pasagjeri apo anëtar i ekuipazhit të fluturimit ose i kabinës së avionit gjatë fluturimit të avionit.

4. Pasagjer, sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij neni, quhet çdo person që transportohet nga një avion, me dijeninë e transportuesit ajror ose të drejtuesit të avionit. Termi pasagjer nuk përfshin personelin në detyrë të ekuipazhit të fluturimit dhe të ekuipazhit të kabinës, të cilët janë në detyrë gjatë fluturimit.

5. Në rast se avioni nuk përdoret për qëllime tregtare, kontrata e sigurimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mbulon dëme sipas përcaktimeve të shkronjave “c” e “ç” të pikës 2 të këtij neni.

6. Kontrata e sigurimit, sipas pikës 1 të këtij neni, mbulon edhe dëme dhe/ose humbje që shkaktohen nga aktet e luftës apo të terrorizmit.

7. Në ndryshim nga sa parashikohet në pikën 6 të këtij neni, për avionët me MTOM deri në 500 kg kontrata e sigurimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mbulon dëme dhe/ose humbje, që shkaktohen nga aktet e luftës ose të terrorizmit.



8. Pronari i avionit të regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kryen fluturime në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, duhet të ketë kontratë sigurimi të vlefshme të sigurimit të përgjegjësisë për dëmet dhe/ose humbjet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga marrëveshjet ndërkombëtare.

9. Në ndryshim nga sa parashikohet në pikën 8 të këtij neni, pronari i avionit të paregjistruar në Republikën e Shqipërisë, fluturimet e të cilit nuk përfshijnë ulje ose ngritje në territorin e Republikës së Shqipërisë, por vetëm fluturime mbi këtë hapësirë, nuk e ka detyrimin e parashikuar në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 2 të këtij neni.

Neni 53

Përgjegjësia e marrjes në sigurim dhe shuma e siguruar

1. Përgjegjësia e siguresit, që rrjedh nga kontrata e sigurimit sipas pikës 1 të nenit 52 të këtij ligji, korrespondon me shumën e siguruar në fuqi në datën kur ka ndodhur humbja, përveç rasteve kur sipas kontratës shuma e sigurimit është më e lartë.

2. Përgjegjësia minimale për një ngjarje të përcaktuar në kontratën e sigurimit sipas pikës 1 të këtij neni, është si më poshtë:

a) për dëmet dhe/ose humbjet ndaj palëve të treta:

i. për paraglidërs, deltaplanët me motor (*motor gliders*), si dhe deltaplanët që manovrohen nga toka, për të cilët MTOM është mbi 20 kg, është minimalisht 10 000 SDR;

ii. për balonat me fluturim të lirë (*unattached balloons*) me ekuipazh është minimalisht 20 000 SDR;

iii. për avionët, MTOM e të cilëve është:

- nga 20 në 500 kg	750 000 SDR
- nga 501 në 1 000 kg	1 500 000 SDR
- nga 1 001 në 2 700 kg	3 000 000 SDR
- nga 2 701 në 6 000 kg	7 000 000 SDR
- nga 6 001 në 12 000 kg	18 000 000 SDR
- nga 12 001 në 25 000 kg	80 000 000 SDR
- nga 25 001 në 50 000 kg	150 000 000 SDR
- nga 50 001 në 200 000 kg	300 000 000 SDR
- nga 200 001 në 500 000 kg	500 000 000 SDR
- mbi 500 000 kg	700 000 000 SDR

b) për një pasagjer 250 000 SDR;

c) për sendet personale të vendosura në kabinën e avionit 1 000 SDR;

ç) për mallrat në transport dhe bagazhet e pranuar (*check-in*) 17 SDR për kg.

3. Përveç sa është parashikuar në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, shuma minimale e siguruar për një ngjarje, e përcaktuar në kontratën e sigurimit, sipas pikës 1 të nenit 48 të këtij ligji, për avionë me MTOM deri në 2 700 kg, të cilët nuk përdoren për qëllime tregtare, mund të arrijë një nivel më të ulët të përgjegjësisë, por jo më të vogël se 100 000 SDR për pasagjer.

KREU IX

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 54

Masat administrative të Autoritetit

1. Për shkeljen e dispozitave të neneve 7, 10, 11, 37, 40, 42 dhe 43 të këtij ligji, Autoriteti mund të marrë ndaj shoqërisë së sigurimit, në mënyrë të përshkallëzuar, masat administrative të mëposhtme:

a) shpall publikisht, me shpenzimet e veta, të dhëna rreth praktikave të gabuara të shoqërive të sigurimit;

b) tërheq miratimin për anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë së sigurimit;

c) pezullon përkohësisht ose revokon licencën për kryerjen e veprimtarisë përkatëse të sigurimit kur vëren raste të përsëritura të shkeljeve.

Neni 55

Shkelja e dispozitave nga shoqëria e sigurimit

1. Autoriteti vendos sanksione me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë ndaj shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj kur kontrata e sigurimit nuk përmban kërkesat e parashikuara në pikën 4 të nenit 15 të këtij ligji.

2. Në rastin e shkeljeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Autoriteti vendos gjithashtu gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për personat përgjegjës të shoqërisë së sigurimit.

3. Autoriteti vendos gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 500 000 (një milion e



pesëqind mijë) lekë ndaj shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj kur:

a) harton një kontratë sigurimi në kundërshtim me dispozitat e pikës 1 të nenit 15 të këtij ligji;

b) nuk i dorëzon të siguruarit Raportin Evropian të Aksidenteve, sipas pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji;

c) refuzon lidhjen e kontratës së sigurimit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 15 të këtij ligji;

ç) ushtron veprimtari në sigurimet e detyrueshme sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji dhe nuk është anëtar i Byrosë;

d) nuk financon buxhetin ndaj Byrosë sipas pikës 8 të nenit 35 të këtij ligji;

dh) nuk financon, si dhe nuk depoziton fondin e garancisë së kartonit jeshil të përcaktuar në përputhje me nenin 37 të këtij ligji;

e) vepron në kundërshtim me nenet 31 dhe 33 të këtij ligji.

4. Autoriteti vendos gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë për personat përgjegjës të shoqërisë së sigurimit, në rast të shkeljeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti vendos gjobë nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë ndaj shoqërisë së sigurimit dhe degës së shoqërisë së huaj kur kjo shoqëri apo degë:

a) vepron në kundërshtim me nenin 7 të këtij ligji;

b) vepron në kundërshtim me nenin 10 të këtij ligji;

c) trajton kërkesën për dëmshpërblim në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji;

ç) i ofron palës së dëmtuar vlerën e dëmshpërblimit në kundërshtim me nenin 11 të këtij ligji;

d) nuk financon vlerën minimale të Fondit të Kompensimit të përcaktuar në nenin 41 të këtij ligji;

dh) nuk krijon dhe mban provigjone teknike sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 40 të këtij ligji;

e) nuk kontribuon financiarisht në Fondin e Kompensimit, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të nenit 42 të këtij ligji;

ë) vepron në kundërshtim me parashikimet e nenit 43 të këtij ligji;

f) nuk raporton në përputhje me rregullat sipas pikës 11 të nenit 35 të këtij ligji;

g) vepron në kundërshtim me pikën 4 të nenit 31 të këtij ligji;

gj) vepron në kundërshtim me nenin 40 të këtij ligji;

h) shkel dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.

6. Në rast të konstatimit të shkeljeve të përcaktuara në pikën 5 të këtij neni, Autoriteti vendos gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë edhe ndaj personave përgjegjës të shoqërisë së sigurimit.

7. Në rast të konstatimit të shkeljeve të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, Autoriteti vendos gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë ndaj vlerësuesit të dëmeve në sigurime.

8. Autoriteti vendos gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë ndaj shoqërisë së sigurimit në rast të refuzimit të kontributit financiar dhe furnizimit me të dhëna, të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji.

9. Autoriteti vendos gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë për personat përgjegjës të shoqërisë së sigurimit në rast të shkeljeve të pikës 8 të këtij neni.

Neni 56

Shkeljet e dispozitave nga Byroja

1. Autoriteti vendos gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë ndaj Byrosë kur:

a) nuk administron dhe përdor fondin e garancisë së kartonit jeshil sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ose rregullore, sipas neneve 37 dhe 38 të këtij ligji;

b) nuk propozon, krijon dhe administron fondin e kompensimit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ose rregullore sipas neneve 41, 42 dhe 48 të këtij ligji;

c) nuk i jep një ofertë ose informacion të arsyetuar palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, ku Byroja është e detyruar të paguajë kompensimin sipas këtij ligji;

ç) nuk i paguan palës së dëmtuar vlerën e dëmit sipas nenit 10 të këtij ligji, për të cilën është e detyruar sipas përcaktimeve të këtij ligji;

d) trajton kërkesën për dëmshpërblim në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji;



dh) nuk raporton në përputhje me rregullat sipas pikës 11 të nenit 35 të këtij ligji.

2. Në rast të shkeljeve të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri 200 000 (dyqind mijë) lekë edhe ndaj personave të tjerë përgjegjës të Byrosë.

3. Autoriteti vendos gjobë në masën nga 200 000 (dyqind mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë ndaj drejtorit ekzekutiv të Byrosë kur:

a) nuk njofton Autoritetin sipas përcaktimeve të pikës 5 të nenit 37, si dhe nuk raporton sipas nenit 38 të këtij ligji;

b) nuk zbaton kërkesat e pikës 4 të nenit 42, si dhe nuk raporton sipas nenit 48 të këtij ligji;

c) nuk i vë në dispozicion palës së dëmtuar ose çdo pale tjetër, të përfshirë në aksident, informacionin e disponueshëm dhe nuk i mundëson përdorimin e këtij informacioni në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

ç) nuk ndjek procedurat e rimbursimit nga personi përgjegjës sipas përcaktimit të këtij ligji.

4. Në rast të shkeljeve, sipas pikës 3 të këtij neni, Autoriteti vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë edhe ndaj personit përgjegjës të Byrosë.

5. Autoriteti vendos gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimit për mosfurnizimin me të dhëna, të parashikuara në pikën 11 të nenit 35 të këtij ligji.

6. Në rast të mospërmbushjes së detyrave nga drejtori ekzekutiv i Byrosë dhe anëtari i Bordit të Drejtorëve, si dhe kërkesave për përshtatshmëri dhe aftësi, Autoriteti mund të revokojë emërimin e dhënë.

Neni 57

Përsëritja e shkeljeve të dispozitave

Autoriteti në rast të përsëritjeve të shkeljeve mund të vendosë dyfishimin e sanksioneve të parashikuara në nenet 55 dhe 56 të këtij ligji.

KREU X

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 58

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për mbrojtjen për miratimin e aktit nënligjor në zbatim të pikës 3 të nenit 2 të këtij ligji brenda 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për punët e brendshme, ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për miratimin e marrëveshjes në zbatim të pikës 5 të nenit 34 të këtij ligji brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Ngarkohet Autoriteti që brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të miratojë udhëzimet dhe rregulloret e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 59

Dispozitë kalimtare

1. Organizimi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit, sipas neneve 35 dhe 36 të këtij ligji, bëhet brenda 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Vlera minimale e fondit të kompensimit me qëllim pagesën e dëmeve, sipas pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, krijohet brenda 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Autoriteti miraton rregulla për mënyrën e administrimit dhe pagesave të praktikave, objekt i fondit të kompensimit, me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Kërkesat për dëmshpërblim me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi në datën e aksidentit.

Neni 60

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 10 076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar, shfuqizohet.



Neni 61
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 korrik 2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 16.3.2021.

VENDIM
Nr. 32/2021

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 12 055, DATË 26.3.2021, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 30/2021 ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 12/2018, ‘PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 12 055, datë 26.3.2021, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 30/2021, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018, ‘Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 4.5.2021.

VENDIM
Nr. 33/2021

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 12 078, DATË 6.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 32/2021, ‘PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 12 078, datë 6.4.2021, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 32/2021, ‘Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 4.5.2021.

VENDIM
Nr. 45/2021

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR HETIMIN E SHKELJEVE TË RËNDA KUSHTETUESE NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3; 5, pika 2, dhe 8, pika 1, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të neneve 55 dhe 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në kërkesën e 49 deputetëve të Kuvendit,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

II. Ky hetim ka për qëllim verifikimin e mënyrës së ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga ana e Presidentit të Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021.

III. Objektet e punës së komisionit hetimor janë:

a) hetimi dhe verifikimi nëse aktet e kryera dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës;

b) verifikimi i pasojave të këtyre akteve në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë;

c) verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit të Republikës, në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese

IV. Komisioni Hetimor parlamentar përbëhet nga 9 deputetë, si më poshtë:

- | | |
|--------------------|-----------------|
| 1. Alket Hyseni | Kryetar |
| 2. Myslim Murrizi | Zëvendëskryetar |
| 3. Klotilda Bushka | Anëtare |
| 4. Vasilika Hysi | Anëtare |
| 5. Elena Xhina | Anëtare |
| 6. Spartak Braho | Anëtar |
| 7. Halil Jakimi | Anëtar |
| 8. Nikolin Staka | Anëtar |
| 9. Arlind Çaçani | Anëtar |

Anëtarë zëvendësues caktohen:

- | | |
|-------------------|--|
| 1. Ermonela Felaj | Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste |
| 2. Xhemal Qefalia | Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste |

3. Edmond Stojku Grupi Parlamentar “Demokraci dhe drejtësi”

4. Eugen Bojaxhiu Grupi Parlamentar “Demokraci dhe drejtësi”

V. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqitet Kuvendit në mënyrë të arsyetuar nëse ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-javor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të Kuvendit, si dhe të ngrejë Sekretariatit Teknik në mbështetje të veprimtarisë së komisionit dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 7.5.2021

AKT NORMATIV
Nr. 20, datë 5.5.2021

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8438,
DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 38, “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, pas pikës 13 shtohet pika 14, me këtë përmbajtje:

“14. Përjashtimisht nga parashikimet e neneve 13 dhe 13/6, të këtij ligji, dorëzimi i deklaratës vjetore individuale të të ardhurave të vitit 2020 në administratën tatimore dhe pagesa e detyrimit, nëse rezulton, bëhet jo më vonë se data 30 qershor 2021. Sanksionet administrative që mund të aplikohen në bazë të nenit 13/9 falen, me kusht që



dorëzimi i deklaratës dhe pagesa e detyrimit të kryhen deri në datën 30 qershor 2021.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 247, datë 5.5.2021

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Aspasjana Kongo, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lirohet nga kjo detyrë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 248, datë 5.5.2021

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Bora Muzhaqi emërohet zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 249, datë 5.5.2021

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Dallëndyshe Bici emërohet zëvendësministër i Mbrojtjes.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 253, datë 5.5.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH, TË MARRËVESHJES SË
KONTRIBUTIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCave DHE EKONOMISË
(MARRËSI) DHE AGJENCISË SUEDEZE
PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR
(SIDA), PËR MBËSHTETJEN E
PROJEKTIT “IMPLEMENTIMI I
TAKSËS SË PASURISË TË BAZUAR NË
VLERËN E TREGUT, VERSIONI 0.93,
DATË 20 SHKURT 2018”, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 408, DATË 4.7.2018, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së
Faqe | 6735



Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi) dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), për mbështetjen e projektit “Implementimi i taksës së pasurisë të bazuar në vlerën e tregut, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018”, miratuar me vendimin nr. 408, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Amendim i Marrëveshjes në lidhje me mbështetjen ndaj projektit “Krijimi i sistemit tatimor mbi pronat e bazuara në vlerën e tregut në Shqipëri” ndërmjet Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), të përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Shqipëri, dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“Përfituesi”)

Kontributi i SIDA-s nr. 11217

Amendimi nr. 1

Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), e përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Tiranë dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, lidhën një Marrëveshje në datën 31 maj 2018 mbi projektin “Krijimi i sistemit tatimor mbi pronat e bazuara në vlerën e tregut në Shqipëri”.

Palët tashmë kanë vendosur të amendojnë Marrëveshjen, siç përcaktohet në nenet më poshtë. Kushtet e pandryshuara në Marrëveshje do të vijojnë të mbeten të pacenuara.

Nenet 1, 2 (B), 3 (A) dhe 10 të Marrëveshjes së lartpërmendur do të ndryshohen si më poshtë:

§ 1. Programi/projekti

Në vend të:

Përfituesi dhe SIDA bien dakord që Projekti të kryhet në përputhje me projektdokumentin (shtojca 1) me titull “Krijimi i sistemit tatimor mbi pronat e bazuara në vlerën e tregut në Shqipëri”, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018.

Tashmë përmban tekstin:

Përfituesi dhe SIDA bien dakord që Projekti të kryhet në përputhje me projektdokumentin (shtojca 1) me titull “Krijimi i sistemit tatimor mbi pronat e bazuara në vlerën e tregut në Shqipëri”, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018 dhe Plani i Shtirjes Protatimore, versioni 1.0, datë 25.1.2021, për vitet 2021–2022, shtojca 2.

§ 2. Kontributi suedez

Në vend të:

B. Shumat tavan/maksimale për pagesat nga SIDA kufizohen si më poshtë:

Tarifat	11 899 000 SEK (krona suedeze)
Të rimbursueshmet	1 927 000 SEK (krona suedeze)
Kosto të tjera	22 155 000 SEK (krona suedeze)
Kontingjencat	300 000 SEK (krona suedeze)
Totali	36 281 000 SEK (krona suedeze)

Buxheti i specifikuar bashkëlidhet si pjesë e Projekt dokumentit/shtojca 1.

Tashmë përmban tekstin:

B. Shumat tavan/maksimale për pagesat nga SIDA kufizohen si më poshtë:

Tarifat	16 376 116 000 SEK (krona suedeze)
Të rimbursueshmet	2 473 818 SEK (krona suedeze)
Kosto të tjera	16 730 339 SEK (krona suedeze)
Kontingjencat	170 625 SEK (krona suedeze)
Totali	36 281 000 SEK (krona suedeze)

Buxheti i specifikuar bashkëlidhet në Planin e Shtirjes Pro-tatimore.

§ 3. Kushtet për kontributin suedez

Në vend të:

Vetëm kostot për aktivitetet e kryera gjatë periudhës që është planifikuar të fillojë nga data 15 mars 2018 dhe që do të finalizohet deri më 31 dhjetor 2020, mund të financohen nga kontributi suedez.

Tashmë përmban tekstin:

Vetëm kostot për aktivitetet e kryera gjatë periudhës që është planifikuar të fillojë nga data 15 mars 2018 dhe që do të finalizohet deri më 31 dhjetor 2022, mund të financohen nga kontributi suedez.

§ 10. Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Në vend të:

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe pasi Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ketë njoftuar SIDA-n me shkrim se procedurat e brendshme bazuar në legjislacionin shqiptar, të cilat janë të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë përmbushur dhe mbeten në fuqi deri në datën 31



dhjetor 2021, nëse nuk përfundon më herët me anë të një njoftimi me shkrim tre muaj para nga Përfituesi ose SIDA.

Tashmë përmban tekstin:

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën 1 janar 2021. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në datën 31 dhjetor 2023, nëse nuk përfundon më herët me anë të një njoftimi me shkrim tre muaj para nga Përfituesi ose SIDA.

Dy origjinalët e këtij amendimi janë nënshkruar, nga të cilat palët kanë marrë një secila.

Tiranë, 28.1.21
Vendi dhe data
Në emër të SIDA-s

4.2.2021
Vendi dhe data
Në emër të Ministrisë së
Financave dhe Ekonomisë
Nënshkrimi Vula

Nënshkrimi

Marie Bergstrom
Drejtuese e
Bashkëpunimit për
Zhvillim
Ambasada e Suedisë në
Tiranë
(Emri/mbiemri/titulli)

Anila Denaj
Ministre
(Emri/mbiemri/titulli)

VENDIM

Nr. 254, datë 5.5.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 872, DATË 11.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2021, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasqyra nr.1, bashkëlidhur vendimit nr. 872, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave,

zëvendësohet me pasqyrën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
(ERRU)

Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2021

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2021 (lekë)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	31,638,500
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	5,508,420
3	Shërbime e furniturë	14,087,630
4	Investime	685,000
	TOTALI	51,919,550

VENDIM

Nr. 258, datë 5.5.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 175, DATË 17.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SPITALIT RAJONAL ‘MEMORIAL’ NË FIER, SI PROJEKT PILOT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 175, datë 17.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:



a) Shkronja “c”, e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) një përfaqësues i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë;”.

b) Pas pikës 19, të shtojcës nr. 1, “Lista e shërbimeve spitalore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e vendimit nr. 175, datë 17.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

“19/1. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësorë, laborator i mjekësisë nukleare);”.

II. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 259, datë 5.5.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 789, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, STANDARDEVE DHE PROCEDURAVE TË CERTIFIKIMIT PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 33, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 789, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 2 dhe 3.1 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Kohëzgjatja e programit të certifikimit

Programi i certifikimit, i kryer nga organi certifikues i akredituar sipas ISO/IEC 17024, për profesionistët e shëndetësisë, është i organizuar në cikël individual që përputhet me afatin kohor të licencimit, brenda të cilit profesionistët e shëndetësisë duhet të përmbushin kriteret siç përcaktohen në pikat 3 dhe 4, të këtij kreu.

3.1 Brenda një cikli individual, mjekët duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 150 kredite të edukimit në vazhdim, stomatologët dhe farmacistët e ndihmësfarmacistët 75 kredite, ndërsa infermierët e mamitë 50 kredite.”.

b) Nën-pika 3.1.2 shfuqizohet.

2. Në pikën 1, të kreut IV, fjalët “... cikël 4-vjeçar...” zëvendësohen me “... cikël individual...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

NJOFTIMI
Nr. 5303, datë 4.5.2021

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJËMARRËVESHJEJE DYPALËSHE

“Marrëveshja e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”, nënshkruar më 5.2.2021, në Tiranë, hyn në fuqi më datë 3 maj 2021.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË DREJTORINË E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR (DSIK)

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, të ndryshuar; në VKM-në nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, dhe në udhëzimin e drejtorit të DSIK-së nr. 99, datë 13.4.2017, “Për zbatimin e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017, ‘Për miratimin e



rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH) në DSIK, ka deklasifikuar informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

a) Deklasifikoi plotësisht Raportet e Grupit të Punës (GP) në DSIK, informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raporti i GP-së nr. 11832, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Genti Skënder Dokollari**”.

2. Raporti i GP-së nr. 11576, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Fahrije Ihsan Stringa**”.

3. Raporti i GP-së nr. 12246, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Sokol Ali Pasho**”.

4. Raportet e GP-së nr. 12435, datë 2.11.2017 dhe nr. 11871 datë 28.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Sokol Dhimo Pina**”.

5. Raporti i GP-së nr. 12074, datë 2.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Dritan Taf Hasani**”.

6. Raporti i GP-së nr. 12114, datë 2.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Miranda Maksut Konica**”.

7. Raporti i GP-së nr. 11429, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ols Milto Dado**”.

8. Raporti i GP-së nr. 11699, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ylli Mejtim Bashaj**”.

9. Raporti i GP-së nr. 11572, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Riselda Zeqir Fishta**”.

10. Raporti i GP-së nr. 12403, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Altin Fehmi Abdiu**”.

11. Raporti i GP-së nr. 12506, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e

figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Arjan Çerçiz Aliaj**”.

12. Raporti i GP-së nr. 11695, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Daniela Kujtim Sulaj**”.

13. Raporti i GP-së nr. 12223, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Shefkie Rexhë Demiraj (Mataj/Hajdarmataj)**”.

14. Raporti i GP-së nr. 12271, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Albert Koço Spiro**”.

15. Raporti i GP-së nr. 12003, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Silvana Mihal Lule**”.

16. Raporti i GP-së nr. 12380, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Avni Daut Kraja**”.

17. Raporti i GP-së nr. 12072, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Ariola Gavrill Kristo**”.

18. Raporti i GP-së nr. 11577, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Isa Riza Jata**”.

19. Raporti i GP-së nr. 12395, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Luan Ramazan Lusha**”.

20. Raporti i GP-së nr. 11701, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Artan Sokrat Gjermëni**”.

21. Raporti i GP-së nr. 11623, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Arian Shyqyri Xhaferraj**”.

22. Raporti i GP-së nr. 12526, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Blerta Baki Marku**”.

23. Raporti i GP-së nr. 12226, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Edlira Vehbi Cufi**”.



24. Raporti i GP-së nr. 12132, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Erjon Besnik Imeraj**”.

25. Raporti i GP-së nr. 12140, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Federik Ndue Laloshi**”.

26. Raporti i GP-së nr. 12548, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Oklkeda Thoma Manellari**”.

27. Raporti i GP-së nr. 11833, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Semiramis Xhevdet Hoxholli**”.

28. Raporti i GP-së nr. 11830, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Mirela Thanas Kapo**”.

29. Raporti i GP-së nr. 12357, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ylli Ndoc Pjetërnikaj**”.

30. Raporti i GP-së nr. 11435, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Irena Ymer Plaku**”.

31. Raporti i GP-së nr. 11761, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Rezarta Hazis Aliu (Paja)**”.

32. Raporti i GP-së nr. 12371, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Arben Besnik Dyla**”.

33. Raporti i GP-së nr. 11842, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ergys Ylli Gashi**”.

34. Raporti i GP-së nr. 12443, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Edmond Halil Kariqi**”.

35. Raporti i GP-së nr. 11555, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Astrit Ibrahim Halilaj**”.

36. Raporti i GP-së nr. 11682, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e

figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Adelajda Astrit Gjuzi**”.

37. Raporti i GP-së nr. 11784, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ahmet Zenel Metaliaj**”.

38. Raporti i GP-së nr. 11757, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Kujtim Kadri Bashaj**”.

39. Raporti i GP-së nr. 11603, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Elion Elmas Mustafaj**”.

40. Raporti i GP-së nr. 12398, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Artan Ukë Hajredinaj**”.

41. Raporti i GP-së nr. 12045, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Arben Lulash Nika**”.

42. Raporti i GP-së nr. 11795, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Anila Okjan Galanxhi Pappa**”.

43. Raporti i GP-së nr. 11796, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ilir Ndue Përdeda**”.

44. Raporti i GP-së nr. 12079, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Alketa Hiqmet Zifla (Llapi)**”.

45. Raporti i GP-së nr. 11883, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Evjeni Harito Sinojmeri (Kaso)**”.

46. Raporti i GP-së nr. 12472, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Lindita Shefqet Sinanaj**”.

47. Raporti i GP-së nr. 12061, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Elda Sulejman Vrioni (Verjoni)**”.

48. Raporti i GP-së nr. 11762, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Markelian Gëzim Kuqo**”.



49. Raporti i GP-së nr. 12529, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Zamira Ibrahim Vyshka**”.

50. Raporti i GP-së nr. 12228, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ergys Luan Selmani**”.

51. Raporti i GP-së nr. 12445, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Edmond Nuhi Koloshi (Kloshi)**”.

52. Raporti i GP-së nr. 11726, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Kaçe Xhafer Agolli**”.

53. Raporti i GP-së nr. 12084, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Kreshnik Fatos Omari**”.

54. Raporti i GP-së nr. 12411, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Manjola Urim Bejleri**”.

55. Raporti i GP-së nr. 11808, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Granit Bajram Shahu**”.

56. Raporti i GP-së nr. 11748, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Arben Nevruz Mulla (Mullaj)**”.

57. Raporti i GP-së nr. 12498, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ervin Kosta Karanxha**”.

58. Raporti i GP-së nr. 11750, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Saimir Zymer Smaka**”.

59. Raporti i GP-së nr. 12236, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Migena Gjergj Laska**”.

60. Raporti i GP-së nr. 12069, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Violeta Myrteza Shkurta (Hysenbelli-u)**”.

61. Raporti i GP-së nr. 11804, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e

figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Fahrije Halit Gjana (Vata)**”.

62. Raporti i GP-së nr. 11706, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Endrit Elmas Bimi**”.

63. Raporti i GP-së nr. 1371, datë 30.1.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Enkeleda Nazmi Kapedani**”.

b) Deklasifikoi pjesërisht informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raporti i GP-së nr. 11901, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Izet Haxhi Dushaj**”.

2. Raporti i GP-së nr. 789, datë 25.1.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Rita Osman Gjati**”.

3. Raporti i GP-së nr. 1312, datë 3.3.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Matilda Stavri Shalla (Thomollari)**”.

4. Raporti i GP-së nr. 1313, datë 3.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Natasha Petraq Prifti (Shallapi)**”.

5. Raporti i GP-së nr. 993, datë 26.1.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Alma Tomorr Ahmeti**”.

6. Raporti i GP-së nr. 1392, datë 4.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Arben Sabri Dosti**”.

7. Raporti i GP-së nr. 1444, datë 8.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Durim Ilmi Hasa**”.

8. Raporti i GP-së nr. 1453, datë 11.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ali Haqif Koleci**”.

9. Raporti i GP-së nr. 1454, datë 11.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Mirela Jorgji Iliopullo (Kore)**”.

10. Raporti i GP-së nr. 1451, datë 11.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Saemira Jorgji Hila**”.

11. Raporti i GP-së nr. 1450, datë 11.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Bujar Qazim Musta**”.



12. Raporti i GP-së nr. 1452, datë 11.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Binas Dilver Nina**”.

13. Raporti i GP-së nr. 1522, datë 12.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Taulant Shamet Banushi**”.

14. Raporti i GP-së nr. 2357, datë 9.3.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ken Vasil Dhima**”.

15. Raporti i GP-së nr. 2197, datë 3.3.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Besjana Fadil Garxenaj**”.

16. Raporti i GP-së nr. 2004, datë 1.3.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Pëllumb Isa Vehbi**”.

17. Raporti i GP-së nr. 2331, datë 8.3.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Erion Nadi Çelaj**”.

18. Raporti i GP-së nr. 12311, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Ajola Faik Prençi**”.

19. Raporti i GP-së nr. 11897, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Klorinda Shyqyri Çela**”.

20. Raporti i GP-së nr. 12402, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Guximtar Çarçan Boçi**”.

21. Raporti i GP-së nr. 3226, datë 8.4.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Lindita Shefqet Sinanar**”.

22. Raporti i GP-së nr. 3227, datë 8.4.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Alfred Avdyl Shehu**”.

23. Raporti i GP-së nr. 2627, datë 18.3.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **znj. Luveda Luan Dardha**”.

24. Raporti i GP-së nr. 2483, datë 16.3.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Gentian Spiro Stoja**”.

25. Raporti i GP-së nr. 2605, datë 18.3.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ramazan Sabri Avdiu**”.

26. Raporti i GP-së nr. 1523, datë 12.2.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ervin Adem Begiri**”.

27. Raporti i GP-së nr. 3348, datë 12.4.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ervin Kosta Karanxha**”.

28. Raporti i GP-së nr. 3706, datë 20.4.2021, me lëndë: “Dërgohet raporti e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Kreshnik Gëzim Ajazi**”.

c) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në *Web* të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

VENDIM
Nr. 98, datë 16.4.2021

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY”
SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”; të nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 47/4 prot., datë 12.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për licencimin e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 80, datë 23.3.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.



- Në vijim të vendimarrjes së ERE-s, me shkresën nr. 6/11 prot., datë 23.3.2021, është bërë publikimi në median e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk rezulton të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 500 prot., datë 31.3.2021, ka njoftuar shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k., lidhur me vendimarrjen e Bordit, për fillimin e procedurave për licencimin e saj në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar, apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 80/2021.

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 500/1 prot., datë 8.4.2021, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e regjistrimit për aplikim, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Aplikimi i shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”), plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”), plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Dragobia Energy” në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 99, datë 16.4.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC “VARDARI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1972 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/3 prot., datë 16.2.2021 dhe relacionin nr. 46/7 prot., datë 13.4.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Vardari’, me kapacitet të instaluar 1972 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 10, datë 20.1.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendndodhje në përroin e Vardarit dhe Valit, degë



e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje me “Njoftimin për licencim” nr. 6/5 prot., datë 20.1.2021, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Gerti” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 264 prot., datë 1.2.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe i komunikoi detyrimin për plotësimin e dokumentacionit të munguar, të pasqyruar në vendimin e fillimit të procedurës.

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 264/1 prot., datë 10.2.2021 dhe atë nr. 5/1 prot., datë 11.2.2021, ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar.

- Në mbledhjen e Bordit të datës 22.2.2021, u konstatua nevoja e kërimit të informacionit, në lidhje me përthithjen e të drejtave të shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., nga “Gerti” sh.p.k., në vijim të “Amendimit të kontratës” nr. 1818 rep. dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020, “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari”, me kapacitet 1.972 mw, në përroit të Vardarit dhe Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, me anë të së cilës të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., i janë transferuar shoqërisë “Gerti” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 58, datë 22.2.2021, vendosi të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në mënyrë që brenda 15 ditëve pune shoqëria të përcjellë dokumentacionin e përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi.

- Shoqëria ka përcjellë korrespondencën e protokolluar me nr. 405/3 prot., datë 8.4.2021, me anë të së cilës ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Po ashtu, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405/5 prot., datë 13.4.2021, ka depozituar:

- Kontratën për shitblerjen e kuotave (HEC “Vardari”), të nënshkruar në datën 24.6.2020, midis shoqërive “Drini Bulqizë” sh.p.k., në cilësinë e shitësit, dhe “Gerti” sh.p.k. në cilësinë e blerësit;

- Vendimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., të datës 26.5.2020, me anë të të cilit është miratuar shitja e 100% të kuotave të HEC “Vardari”, shoqërisë “Gerti” sh.p.k.; dhe

- Vendimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Gerti” sh.p.k., të datës 26.5.2020, me anë të të cilit është miratuar blerja e 100% të kuotave të HEC “Vardari”, shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405/6 prot., datë 13.2.2021, shoqëria ka bërë me dije se ndodhet në proces të vlerësimit të aseteve dhe investimeve, të cilat duhet të pasqyrohen në bilanc dhe meqenëse bilanci i vitit 2020 nuk është mbyllur ende, shoqëria do të raportojë në vijim për to.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar, si më poshtë, me përjashtim të kontratës së qirasë, të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Bashkisë Librazhd, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, ndërtimi dhe shfrytëzimi i HEC “Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar, për të cilën shoqëria i është drejtuar Bashkisë Librazhd me shkresën nr. 31 prot., datë 18.3.2021, duke i kërkuar zëvendësimin e qiramarrësit në kuptim të amendimit të kontratës me nr. 1818 rep. dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020, “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 mw, në përroit të Vardarit dhe Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”. Si e tillë, vlerësohet e nevojshme vendosja e një kushti në dispozitiv të vendimit që shoqëria “Gerti” sh.p.k., të depozitojë në ERE këtë dokument. Lidhur me dokumentet e tjera, konstatohet se:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, 4.1.4,



germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe 4.1.5, gjerat: “a”, “b”, “c), plotësuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Shoqëria duhet të përcjellë në ERE finalizimin e heqjes nga fondi pyjor kullësor të sipërfaqes së përcaktuar për zhvillimin e projektit.

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Bashkisë Librazhd, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, ndërtimi dhe shfrytëzimi i HEC ‘Vardari’”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 16.10.2022), shoqërisë i duhet ta depozitojë atë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Sikurse kemi cituar edhe më sipër, kontrata nr. 118 rep., nr. 62/2 kol., datë 24.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Vardari’, me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., të drejtat dhe detyrimet e të cilit i janë transferuar më pas shoqërisë “Gerti” sh.p.k., nëpërmjet amendimit të kontratës me nr. 1818 rep. dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020, “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit ‘Vardari’ me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari”, me kapacitet të instaluar 1972 kw, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitojë në ERE kontratën e qirasë, të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Bashkisë Librazhd, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, ndërtimin dhe shfrytëzimin e HEC ‘Vardari’”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2020, ku pasqyrohen asetet fikse të transferuara nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. të shoqëria “Gerti” sh.p.k., brenda datës 30.6.2021.

3. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE finalizimin e heqjes nga fondi pyjor, kullësor të sipërfaqes së përcaktuar për zhvillimin e projektit, jo më vonë se një muaj nga disponimi i tij.

4. Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 16.10.2022), shoqëria “Gerti” sh.p.k. ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 100, datë 16.4.2021

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 132, DATË 6.12.2011, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s, DHE TRANSFERUAR ME VENDIMIN NR. 126, DATË 28.10.2013, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s, TE SHOQËRIA “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ULËZ” ME KAPACITET TË INSTALUAR 24 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 13 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 70, datë 12.3.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, të miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, te shoqëria “Kurum International” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Ulëz” me kapacitet të instaluar 24 mw.

- Në vijim të vendimarrjes së ERE-s, me shkresën nr. 6/9 prot., datë 13.3.2021, është bërë publikimi në median e shkruar, në lidhje me fillimin e procedurës së modifikimit të licencës nr. 213, seria PM13P, dhe në përfundim të afatit të

njoftimit, nuk rezulton të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palët e interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 469 prot., datë 24.3.2021, ka njoftuar shoqërinë “Kurum International” sh.a., lidhur me vendimarrjen e Bordit, për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar, apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 70/2021.

- Shoqëria “Kurum International” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 469/1 prot., datë 2.4.2021, nuk ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e munguar dhe si e tillë ERE iu drejtua sërish me shkresën nr. 469/2 prot., datë 9.4.2021, me anë të së cilës i kërkoi plotësimin e dokumentit që mbetej ende i paplotësuar.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 469/3 prot., datë 12.4.2021, ka përditësuar informacionin mbi kapacitetin e instaluar të HEC “Ulëz”, i cili pas praktikës së prodhimit të tri mujorit të parë, në kushtet e arritjes së kapacitetit maksimal nga situata e reshjeve atmosferike të bollshme dhe në përputhje me të dhënat teknike të projektit të zbatuar të rehabilitimit, është arritur në përfundimin se kapaciteti maksimal gjenerues i HEC “Ulëz” është $4 \times 8.3 = 33.2$ mw, kapacitet ky i konfirmuar i cili duhet të reflektohet në licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa për modifikim vjen për arsye se gjatë rehabilitimit të këtij Hec-i, në lidhje me optimizimin e operimit të turbinave, janë zëvendësuar me pajisje të reja disa pajisje kryesore të Hec-it, çka ka bërë edhe rritjen e kapacitetit të tij.

Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 28.10.2013, është miratuar transferimi te shoqëria “Kurum International” sh.a. i licencave të dhëna me vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 132/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC ULËZ – SHKOPET’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Ulëz dhe Shkopet”, dhe nr. 136/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”, licencat që mbanin shoqëritë “HEC Ulëz – Shkopet” sh.p.k. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.p.k.

- HEC “Ulëz” është ndërtuar në vitin 1957, në lumin e Matit, në Qytetin e Burrelit, rrethi Dibër,



dhe me ligjin nr. 94/2013, datë 4.3.2013, “Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë ‘HEC Ulëz – Shkopet’ sh.a., të lidhur ndërmjet METE-s (sot MIE) dhe shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a.”, është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve nga shoqëria “HEC Ulëz – Shkopet” sh.a. te shoqëria “Kurum International” sh.a., duke e kaluar këtë HEC në pronësi të “Kurum International” sh.a.

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Kurum International” sh.a., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton i plotësuar tërësisht, si më poshtë:

Neni 9, pika 1, formati i aplikimit:

- germa “a” (të dhënat për aplikim), plotësuar;

- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit), plotësuar;

- germa “c” (të dhëna për aplikuesin), plotësuar.

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin, duke kërkuar informacionin e mëposhtëm:

- germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës, plotësuar;

- germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës, plotësuar;

- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera, plotësuar;

- germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi, plotësuar;

- germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE, plotësuar.

- Në lidhje me këtë modifikim shoqëria ka bërë me dije edhe mbi lejet nga institucionet e tjera, si më poshtë:

- Në lidhje me lejen mjedisore, shoqëria theksoi se modifikimi i licencës nuk ndikon në vlefshmërinë e lejes mjedisore që disponon dhe që është në fuqi. Vlefshmëria e lejes mjedisore, sikurse bërë me dije edhe më herët nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, lidhet me momentin e

ndërtimit të veprës. Aktualisht shoqëria “Kurum International” sh.a. është në operim.

- Po ashtu, shoqëria ka deklaruar se është aktualisht duke operuar me marrëveshjen e lidhjes së re me OST sh.a., e cila është pa afat dhe ka kërkuar nga OST sh.a. modifikimin e kësaj marrëveshjeje, në kuadër të rritjes së kapacitetit të instaluar. Edhe vetë OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 295/2 prot., datë 26.3.2021, ka përcjellë konfirmimin për aftësinë e rrjetit të transmetimit në atë zonë, për përballimin e flukseve të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC Ulëz. OST sh.a., në këtë korrespondencë, ka kërkuar nga ERE edhe miratimin me procedurë të përsheptuar të kësaj praktike, në mënyrë që të vijohet me procedurën e shtesës së kapacitetit të instaluar të HEC “Ulëz” me shoqërinë “Kurum International” sh.a.

- Shoqëria ka dokumentuar në ERE edhe lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar, me nr. 3/13 prot., datë 3.3.2020, të miratuar me vendimin nr. 5, datë 3.3.2020, të Këshillit të Basenit Ujor Mat.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën me nr. 213, seria PM13P, të miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, te shoqëria “Kurum International” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Ulëz”, me kapacitet të instaluar 24 mw, si më poshtë:

Ishte: kapaciteti i instaluar 24 mw.

Bëhet: kapaciteti i instaluar 33.2 mw.

2. Në përmbajtjen e licencës nr. 213, seria PM13P, të pasqyrohen ndryshimet respektive, në përputhje me ndryshimin/rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Ulëz”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Për këtë vendim mund të kërkolet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 101, datë 16.4.2021

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË FTL
SHA, PËR SHTYRJEN E HYRJES NË
FUQI TË VENDIMIT NR. 202, DATË
2.12.2020, PËR MIRATIMIN E
“RREGULLORES PËR PROCEDURAT E
SHITJES SË TEPRICAVE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREGUN
E PARREGULLUAR, PËR SHOQËRINË
PUBLIKE TË FURNIZIMIT”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 53 dhe 92, pikat 1 dhe 2, si dhe nenit 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, pikat 2 dhe 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 47/2 prot., datë 12.4.2021, të Drejtorive Teknike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 37, datë 11.2.2021, vendosi:

“- Shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”, miratuar me

vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, deri në 31 mars 2021.

- Për periudhën tranzitore, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, FTL sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a., të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.”.

- FTL sh.a., me shkresën nr. 320/4 prot., datë 30.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 104/4 prot., datë 31.3.2021, kërkoj shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, duke arsyetuar se “Kontrata e shërbimit, mbi ndryshimet/zhvillimet në platformën IT online të shitjes së energjisë elektrike, me afat zbatimi 65 ditë nga data e lidhjes së kontratës (lidhur më 11 janar 2021), për arsye teknike, të pavarura nga Autoriteti Kontraktor, ofruesi i shërbimit të saj është në vonesë për realizimin e objektit të kësaj kontrate. Në këto kushte, FTL sh.a. është në pamundësi të zbatimit të vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 202, datë 2.12.2020”.

- Në vijim, FTL sh.a., nëpërmjet *e-mail*-it të datës 7 prill 2021, dërguar në ERE në adresën zyrtare erealb@ere.gov.al, kërkoj shtyrjen me një afat 4 muaj, të datës së hyrjes në fuqi të rregullores, sipërcituar.

- ERE vlerëson se, për sa kohë afati i përcaktuar për realizimin e kontratës për implementimin e ndryshimeve/zhvillimeve të platformës IT, të shitjes së energjisë elektrike, sikurse bërë me dije nga FTL sh.a., ka qenë rreth dy muaj (65 ditë), kërkesa e kësaj shoqërie për një shtyrje të afatit me katër muaj është e pa justifikuar, pasi në çdo rast gjykolet se zgjatja e afateve kontraktuale për të përmbyllur punimet e nevojshme nga kontraktori, për implementimin e ndryshimeve/zhvillimeve të platformës IT, nuk duhet të kalojë afatin 65-ditor të përcaktuar në kontratë, për realizimin e këtyre punimeve.

- Në këto kushte, vlerësohet që kërkesa e bërë nga FTL sh.a., për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë



publike të furnizimit”, të pranohet pjesërisht deri më 31 maj 2021. Ky afat, duke iu referuar dhe afatit fillestar të përcaktuar në kontratën për realizimin e ndryshimeve/zhvillimeve të platformës IT të shitjes së energjisë elektrike, gjykohet i mjaftueshëm për të realizuar ndryshimet e nevojshme në platformë, me qëllim përdorimin e saj edhe në procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020.

2. “Rregullorja për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, hyn në fuqi më datë 31 maj 2021.

3. Për periudhën tranzitore, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, FTL sh.a. për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë “Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.”, të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë FTL sh.a. dhe palët e interesit të përfshira në dhënien e opinioneve për draftin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”, “Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES)”, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 102, datë 16.4.2021

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË SHOQËRISË OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA, PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të neneve 15, 19 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 3, pika 3.3, të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 16.4.2021, mbasi shqyrtoi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., për disa ndryshime në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 1384 prot., datë 25.2.2021, ka paraqitur raportin e vlerësimit lidhur me zbatimin e “Rregullave të mekanizmit balancues, për muajin janar 2021”, ku ndër të tjera propozon disa ndryshime në rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike dhe anekset përkatëse, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

- Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, parashikojnë që rregullat mund të ndryshohen bazuar në shkaqe të argumentuara nga ana e OST sh.a. Propozimet e përcjella përmes shkresës nr. 1384 prot., datë 25.2.2021, si ato që lidhen me formën e dokumentit dhe ato që lidhen me përmbajtjen e tij, nuk janë shoqëruar me argumentimet përkatëse ku të evidentohet nevoja për kryerjen e ndryshimit të kërkuar.

- Propozimet e përcjella nuk përmbushin detyrimet që rrjedhin nga pika 3.3, e nenit 3 (miratimi dhe rishikimi), të “Rregullave të Tregut



Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”. OST sh.a., në cilësinë e propozuesit të ndryshimeve të këtij dokumenti, duhet të krijonte një komitet përgjegjës për ndryshimin e rregullave, i cili inicion ndryshimin e tyre. Ky ndryshim i propozuar, në vijim, paraqitet zyrtarisht nga OST për miratim të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1384/2 prot., datë 18.3.2021, në përgjigje të shkresës së ERE-s nr. 397/1 prot., datë 9.3.2021, OST sh.a. ka bërë me dije se, citojmë: “Nuk ka hapur procedurë konsultative me palët e interesit dhe Sekretariatit e Energjisë”, sa i përket propozimeve për ndryshim në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 89, datë 31.3.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., ‘Për rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nga data 1 prill 2021’”, është vendosur tashmë nisja e efekteve financiare të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, “Mbi miratimin e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, për palët përgjegjëse për balancim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e propozimit të shoqërisë OST sh.a., për disa ndryshime në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OST sh.a. mbi vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 103, datë 16.4.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 47/8 prot., datë 14.4.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin mars 2021,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 3808 prot., datë 6.4.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin mars 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021” është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2021” është 1.5 lekë/kWh.



- Sasia e energjisë elektrike e prokuruar në treg të parregulluar dhe nga burimet e rinovueshme është 1,554 MWh.

- Në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të rishikuar,

llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Mars 2021

Mars 2021		Aplikimi FSHU sh.a.		Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.307	6.307
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.19	0.19
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	6.50	6.50
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRrTSHt + CA		Leke/kWh	10.54	10.54

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e përcjella nga FSHU-ja në këtë aplikim lidhur me koston e blerjes së energjisë nëpërmjet FTL sh.a., si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezultojnë se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2021, të jetë 10.54 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 10.54 lekë/kWh, për muajin mars 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 3848, datë 4.5.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit “Sistemi dhe rikonstrukcioni i infrastrukturës në ‘Blllokun Qemal Stafa’ kufizuar nga rrugët ‘Kongresi i Manastirit’ dhe ‘Bajram Curri’, Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, si:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në



Bashkinë Tiranë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprahe e shpronësimit është 132,879,041 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyzet e një) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Etjen Xhafaj**

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I OBJEKTIT "SISTEMI DHE RIKONSTRUKSIONI I INFRASTRUKTURËS NË "BLOKUN QEMAL STAFI" KUFIZUAR NGA RRUGËT "KONGRESI MANASTIRIT" DHE "BAJRAM CURRI"

Nr	Emër Mblimë	Lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	Nr. Pasuri e	Sip. Totale Truall (m²)	Sip. Truall i prekur (m²)	Çmimi Truall (lek/m²)	Sip. Obj. e prekur (m²)	Vlera në lekë	Shënime në kartelë	KONFIRMIM ZVRPP, TIRANË
1	Shet	Trouare	8140	3/45	151.04	21.68	0	0.00	0		Konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
2	Shet	Trouare	8140	3/50	127.67	1.95	0	0.00	0		Konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
3	Shet	Truall	8140	3/52	1070.91	46.44	0	0.00	0	Kopshiti nr.20; C-V.K.M. Nr.219, Dt.21.03.2017	Konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
4	Shet	Shesh	8140	3/101	160.90	12.97	0	0.00	0		Konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
5	Shet	Rruge	8140	3/100	2020.84	2020.84	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020, nr. prot. 8542/3, datë 29.12.2020, nr. prot. 830/1, datë 17.02.2021
6	B.P. Zakia, Duzha, Shehi, Lika	Truall	8140	3/675	286.00	256.87	35199	0.00	9,041,567	C- Korigjim emri	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
7	B.P. Zakia, Duzha, Shehi, Lika	Truall	8140	3/676	253.50	1.44	35199	0.00	50,687	C- Korigjim emri	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
8	Kadri Zakia	Truall	8140	3/305	280.00	191.38	35199	0.00	6,736,385	C- V.K.K.P.	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
9	Shet	Trouare	8140	3/721	41.00	41.00	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
10	Shet	Trouare	8140	3/732	142.00	142.00	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
11	Shet	Rruge	8140	3/733	395.00	395.00	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
12	Shet	Shesh	8140	3/734	85.00	30.73	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
13	Kadri Osman Zakia	Truall	8140	3/630	715.50	300.81	35199	0.00	10,588,211	Vjen nga V.20 Fq.167; C- T. Nd. Pasurie; E- Ka një ndërtim pa leje	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
14	Shet	Truall	8140	3/631	49 (nga matjet del 144.93)	84.13	0	0.00	0	Shënim: Sektori i Shpronësimeve: Ka difference fakt-kartele per siperfaqen e pergjithshme	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020 dhe nr. prot. 8542/3, datë 29.12.2020.
15	Agim Hamid Bekteshi	Truall	8140	3/261	159.00	33.25	35199	0.00	1,170,367	C- K. Dhurimi; E- Pasuria kufizohet Urdher 1449, dt. 09.05.2015	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.



16	Shtet	Rruge	8140	3/747	602.87	602.87	602.87	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
17	Shtet	Trofuare	8140	3/134	111.20	146.88		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
18	B.P. Kullakshi, Mema, Libani, Allmuca, Kallushi	Truall	8140	3/74	333.55	1444.00		35199	0.00	11,740,626	C- Dashmi Trashegimie; E- Ka 3 nderitime pa leje	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
19	Shtet	Shesh	8140	3/68	152.35	223.00		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
20	Shtet	Shesh	8140	3/759	13.88	59.00		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
21	Shtet	Shesh	8140	3/742	43.61	233.64		0	0.00	0	E- Ka 1 nderitim pa leje	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
22	Shtet	Shesh	8140	3/106	274.63	274.63		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
23	Shtet	Trofuare	8140	3/118	365.88	607.22		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
24	Shtet	Rruge	8140	3/111	934.96	934.96		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
25	Shtet	Trofuare	8140	3/722	271.80	278.00		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
26	Shtet	Shesh	8140	3/120	1163.06	1452.90		0	0.00	0	D- Mbi kete truall eshte regjistruar nderitesa me nr.pas 3/851/ND, Vol.39, Fq.6	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
27	Shtet	Rruge	8140	3/725	695.79	695.79		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
28	Shtet	Truall	8140	3/735	10.96	10.96		0	0.00	0	Shtese e Pallatit 3/102; E- Ka nje nderitim pa leje	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
29	B.P. Stafa, Zeqiraj, Sallaku, Sulejmani, Peti	Truall	8140	3/272	122.00	122.00		35199	0.00	0	C- Urdher korrigjimi	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
30	Shtet	Trofuare	8140	3/115	349.25	1096.57		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
31	Shtet	Rruge	8140	3/128	86.00	86.00		0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
32	Kadri Osman Zakja	Truall	8140	3/979	31.41	143.00		35199	0.00	1,105,601	C- T. Nd. Pas.	Konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/3, datë 29.12.2020.



33	Kadri Osman Zakja	Truall	8140	3/978	1161.00	1145.58	35199	0.00	40,323,270	C- T. Nd. Pas.	Konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/3, datë 29.12.2020.
34	Shtet	Rruge	8140	3/168	272.30	161.23	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
35	Zyhra Abdyl Kalaja	Shesh	8140	3/170	816.16	667.39	35199	0.00	23,491,461	C- V.K.K.P.	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
36	Shtet	Rruge	8140	3/41	557.81	557.81	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
37	Shtet	Trotuare	8140	3/47	265.58	132.14	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
38	Shtet	Kabine elektrike	8140	3/46	29.64	23.65	0	29.00	0	KESH; E- Ka nje ndertim pa leje	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
39	Shtet	Trotuare	8140	3/757	369.00	188.02	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
40	Shtet	Rruge	8140	3/54	193.44	193.44	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
41	Shtet	Trotuare	8140	3/60	93.23	93.23	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
42	B.P. Shega, Kamberi, Kullakshi, Bakllava, Kusi, Ismaili, Ibrahim, Bicaku	Truall	8140	3/308	158.00	122.89	35199	0.00	4,325,605	C- Dëshmi trashëgimie	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
43	Shtet	Trotuare	8140	3/65	101.84	98.45	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
44	Shtet	Trotuare	8140	3/61	134.84	15.57	0		0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
45	B.P. Karaj dhe Kruja	Truall	8140	3/283	128.00	106.05	35199	0.00	3,732,854	C- Vendim gjykate	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
46	B.P. Karaj dhe Kruja	Truall	8140	3/284	133.00	93.76	35199	0.00	3,300,258	C- Vendim gjykate	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
47	Shtet	Rruge	8140	3/48	282.70	282.70	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
48	Shtet	Shesh	8140	3/953	301.66	247.10	0	0.00	0	C- T.nd pasurie	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
49	Shtet	Rruge	8140	3/59	153.98	153.98	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.
50	Shtet	Shesh	8140	3/752	139.57	22.72	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot.607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020.



51	Kadi Zakia	Truall	8140	3/84	711.00	477.00	35199	0.00	16,789,923	C- Nd. Pasurie; D- Mbi kete pasur ngrihet ndertesa me nr. 3/84/ND, Vol 40, Fq. 240; E- Ka nje ndertim pa leje	Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
52	Shtet	Ruge	8140	3/763	174.00	41.69	0	0.00	0	E- Okupues Vebi Idriz Dani, Ka nje ndertim pa leje	Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
53	Shtet	Truall	8140	3/986	833.00	14.72	0	0.00	0	C- T. Nd. Pasurie; D- Mbi kete truall ngrihet pasuria ndertese me nr. 3/936/ND, Vol. 37, Fq. 226. Mbi kete pasur ngrihet ndertesa me nr. 3/84/ND, Vol. 40, Fq. 240. V Gj. Vertetim fakti. Mbi kete pasur ngrihet ndertesa me nr. 3/987/ND, Vol. 41, Fq. 109.; E- Te kufizohen veprimet deri ne plotesimin e dokumentacionit ne Ref.	Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
54	Shtet	Shesh	8140	3/900	97.19	83.00	0	0.00	0	E- Ka nje ndertim pa leje	Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
55	Shtet	Ruge	8140	3/150	452.60	214.12	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
56	B.P. Liqa, Sheni	Truall	8140	3/348	428.00	13.70	35199	0.00	482,226	L Leg nr. 997184, date 03.04.2017. Godine Banimi 3 Kale + Papafigo + 2 Godine Sherbimi 1 Kat. Sip K Perdhe 114.8 m2. Sip Soc-Eko 101.5 m2. Sip Banimi 13.3. Sip Verande+Shkalle 10.5 m2. Sip K Pare 157.3 m2. Sip K Dyte 157.3 m2. Sip Papafigo 78.3 m2. Sip Obij Ndihmes 16.6 m2 Soc-Eko. Sip Obij Ndihmes 52.5 m2 Soc-Eko.; C- KSH nr. 9908 REP Nr. 1950 KOL Dt. 30.12.2020.; D- Rivleresohet pasuria per 1/4 pjese takuese te Matlida Duzha ne vleren 22 264 966 lekene baze te Apl nr. 40186, date 06.11.2020. Ne baze te Apl nr. 46032, dt. 30.12.2020 rivleresohet pjesa takuese 1/4 e futura Shehine	Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
57	Shtet	Trotuare	8140	3/750	22.00	1.59	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
58	Shtet	Trotuare	8140	3/139	558.13	101.87	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
59	Shtet	Shesh	8140	3/152	1329.05	1314.35	0	0.00	0	D- Mbi kete pasur bazuar ne tejen e legalizimit eshte regjistruar ndertesa me nr pasurie 3/963/ND, vol. 39 fq. 206 Z K. 8140; Mbi kete pasur ngrihet ndertesa me nr. 3/977/ND, Vol. 40, Fq. 221	Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
60	Shtet	Trotuare	8140	3/151	379.20	10.44	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
61	Shtet	Ruge	8140	3/107	866.92	866.92	0	0.00	0		Konfirm. ZVRPP me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresen nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.



62	Shtet	Rruge	8140	3/109	186.88	186.88	0	0.00	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 8542/1, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
63	Shtet	Trotuare	8140	3/163	72.04	72.04	0	0.00	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
64	Shtet	Shesh	8140	3/140	312.69	94.44	0	0.00	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
65	Shtet	Kabine elektrike	8140	3/153	33.00	12.41	0	12.41	0	KESH; E- Ka një ndërtim pa leje
66	Shtet	Trotuare	8140	3/177	263.44	53.99	0	0.00	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
68	Shtet	Trotuare	8140	3/749	136.14	7.82	0	0.00	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
69	Shtet	Truall	8140	3/941	1436.00	163.60	0	0.00	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
70	Shtet	Trotuare	8140	3/103	237.33	156.69	0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, konfirm. ASHK me shkresën nr. prot. 8542/1, dt. 30.10.2020.
Vlera totale paraprake					17,336.67				132,879.041	

Shënime

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 03.02.2016.
2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresën e ZVRPP, Tiranë, nr. prot. 607/2, dt. 13.02.2019, shkresën e ASHK, Drejtoria Tirana Veri, nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020, nr. prot. 8542/3, datë 29.12.2020 dhe nr. prot. 830/1, datë 17.02.2021.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë